



RAPORTI I PROGRESIT TË KOMPAKTIT

VLERËSIMI I PROGRESIT PËR PERIUdhËN KORRIK 2016 – QERSHOR 2017

PËRMBAJTJA

Parathënie.....	2
Përmbledhje ekzekutive.....	3
KOMPAKT 3.....	5
POLICIA & DOGANA	10
Policia në komunitet	11
Marrëveshjet për bashkëpunim policor	12
Funksionimi i policisë në bazë të analizave dhe të dhënave	13
Njësitë e specializuara dhe ekipet për reagim të shpejtë.....	14
Njësia për trashëgiminë fetare dhe kulturore	15
Policia e Kosovës në pjesën veriore të Kosovës.....	16
Inspektorati Policor i Kosovës.....	18
Dogana e Kosovës dhe Policia Kufitare e Kosovës.....	20
DREJTËSIA.....	22
Monitorimi i rasteve të përzgjedhura të Kosovës.....	23
Këshilli Gjyqësor i Kosovës & Këshilli Prokurorial i Kosovës	25
Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme	28
Paneli i Apelit i Agjencisë Kosovare të Pronës	29
Shërbimi Korrektues i Kosovës.....	30
Instituti i Mjekësisë Ligjore	32
ZBATIMI I DIALOGUT.....	34
Regjistri civil	35
Liria e lëvizjes	37
Marrëveshja për MIK/IBM	38
Integrimi i drejtësisë	39
Lista e Shkurtesave	40

PARATHËNIE

Kemi nderin të prezantojmë Raportin e pestë të Progresit të Marrëveshjes Kompakte, i cili shënon një arritje tjetër në kuadër të përkushtimit tonë për fuqizimin e sundimit të ligjit në Kosovë. Ky Raport ofron një përmbledhje vjetore të progresit të bërë në fushat me prioritet të dakorduara ndërmjet aktorëve

Bordi i Përbashkët Bashkërendues për Sundimin e Ligjit është mekanizëm bashkërendues ndërmjet institucioneve kosovare, Përfaqësueses Speciale të Bashkimit Evropian/Zyrës së BE-së në Kosovë dhe EULEX-it. Ai ndjek objektiva të përbashkëta të lidhura me angazhimet e BE-së për reformat në kuadër të fushës së përgjithshme të sundimit të ligjit në Kosovë. Ky Bord përcakton objektivat specifike të përbashkëta për sundimin e ligjit – në formë të një Marrëveshjeje KOMPAKTE – takohet rregullisht për të shqyrtuar progresin e arritur, si dhe pajtohet për veprimet vijuese për zgjidhjen e pengesave dhe avancimin e çështjeve teknike.

kryesorë të Bordit të Përbashkët Bashkërendues për Sundimin e Ligjit. Në dhjetor 2016, ne nënshkruam Marrëveshjen Kompakte të tretë me 12 objektiva të përbashkëta të përditësuara, me çka e kemi ripërtërirë zotimin tonë ndaj reformës në proces të sundimit të ligjit në Kosovë.

Ky Raport i Progresit të Kompaktit përfshin periudhën prej korrikut 2016 deri në qershor 2017, e cila shënon një fazë të rëndësishme për institucionet e sundimit të ligjit në Kosovë. Meqë ky raport përfshin vitin e parë të mandatit të përtërirë dyvjeçar të EULEX-it – ndërsa ky Mision e vazhdon angazhimin e tij pas një reduktimi të konsiderueshëm – në të bëhet vlerësimi i progresit të arritur gjatë një periudhe kohore në të cilën institucionet kosovare të sundimit të ligjit morën përsipër përgjegjësi të shtuara për ushtrimin e pavarur të funksioneve të tyre. Ndonëse gjatë kësaj

periudhe gjithsesi është arritur progres, për fat të keq disa zhvillime të nevojshme në institucione dhe fusha tematike të caktuara kanë ngecur prapa. Me rëndësi është që ky Raport nënvizon aftësinë e institucioneve kosovare për të shfrytëzuar përvojën e tyre në mënyrë që të bëjnë arritje të mëtejme në periudhën që vjen.

Ne, të nënshkruarit më poshtë, besojmë se përpjekjet tona të përbashkëta dhe mbështetja e vazhdueshme për institucionet kosovare të sundimit të ligjit do të jenë një shtysë plotësuese për adresimin e sfidave të mbetura dhe arritjen e përmirësimeve të nevojshme për shoqërinë kosovare.

Ministri i Drejtësisë

Abelard Tahiri

Kryesuesi i Këshillit
Gjyqësor të Kosovës

Nehat Idrizi

Kryesuesi i Këshillit
Prokurorial të Kosovës

Blerim Isufaj

Udhëheqësja e Misionit Evropian
për Sundimin e Ligjit në Kosovë

Alexandra Papadopoulou

Përfaqësuesja Speciale e BE-së në Kosovë/
Udhëheqësja e Zyrës së BE-së në Kosovë

Nataliya Apostolova

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Në periudhën prej muajit korrik 2016 deri në qershor 2017, institucionet kosovare kanë bërë progres në përmirësimin e sektorit të sundimit të ligjit në Kosovë, duke treguar aftësi në rritje për të kapërcyer sfidat e sundimit të ligjit në mënyrë të pavarur. Mirëpo, ndërsa vazhdojnë të jenë të përkushtuara për agjendën e përbashkët të sundimit të ligjit, institucionet megjithatë duhet t’u përgjigjen në mënyrë efektive problemeve të vazhdueshme të ndërhyrjes politike dhe korrupsionit – ku natyra e gjerë e shtrirjes së tyre i lë notë negative sukseseve të arritura në fushat e tjera. Institucionet kosovare duhet të zotohen më shumë për t’iu përgjigjur në mënyrë adekuate këtyre problemeve gjithëpërfshirëse.

Policia e Kosovës në përgjithësi e ka ruajtur nivelin e lartë të qëndrueshmërisë dhe llogaridhënies gjatë ofrimit të shërbimeve për zbatimin e ligjit. Ende janë të pranishme disa zbrazëti dhe mangësi, veçanërisht në mbajtjen e numrit të mjaftueshëm të personelit të trajnuar për fusha tematike të ndryshme, si dhe në arritjen e nivelit të standardizuar të pajisjeve në tërë këtë organizatë. Për më tepër, Policia e Kosovës në veri të Kosovës vazhdon të ballafaqohet me pengesa për zhvillimin e mëtejshëm të saj për shkak të ndikimeve politike, sistemit gjyqësor të pakompletuar dhe mungesës së ndërsjellë të besimit me drejtorinë e përgjithshme në Prishtinë.

Edhe pse ka siguruar një rritje të buxhetit të tij për vitin 2017, Inspektorati Policor i Kosovës është përballur me shumë sfida për të arritur kapacitet të plotë funksional si një agjenci e pavarur që punon për të siguruar llogaridhënien e policisë. Niveli i bashkëpunimit me organet e tjera të zbatimit të ligjit nuk ishte ende në nivelin e dëshiruar, kurse ndryshimet e domosdoshme legjislative për të rregulluar *Ligjin për Inspektoratin Policor të Kosovës* dhe për ta harmonizuar atë me ligjet e tjera nuk ishin futur në Programin Legjislativ të Qeverisë për vitin 2017.

Dogana e Kosovës e ka vazhduar performancën e saj në përputhje me apo mbi parashikimet e arkëtimit të të hyrave. Përmes operacioneve të përbashkëta e të rregullta me organet e tjera për zbatimin e ligjit, ajo ka treguar një përmirësim të dukshëm në praktikën e saj të punës. Kosova ka shënuar përmirësime të konsiderueshme në fushën e menaxhimit të kufirit, duke u anëtarësuar në Organizatën Botërore të Doganave dhe duke e zhvilluar bashkëpunimin me FRONTEX-in.

EULEX-i ka bërë monitorimin e rasteve të përzgjedhura të dorëzuara autoriteteve vendase nga EULEX-i përgjatë tërë kësaj periudhe. Kjo punë – e kryer në gjykatat e niveleve të ndryshme në tërë Kosovën – ka shpërfaqur një sërë problemesh (të ravijëzuara në këtë raport) që duhen zgjidhur nëse dëshirohet që Kosova të ketë sundim funksional të ligjit në përputhje me standardet e BE-së dhe praktikën më të mira.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe Këshilli Prokurorial i Kosovës kishin një vit mjaft të ngjeshur gjatë të cilit ata administruan proceset për përzgjedhjen dhe punësimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në tërë Kosovën, përfshirë edhe në veri të vendit. Ata kanë vazhduar të punojnë në rregulloret e përfshira në “Pakon e Drejtësisë 2015” dhe rregulloret e tjera të domosdoshme për funksionimin efektiv të tyre.

Ndërsa është arritur progres veçmas në lidhje me Këshillin Prokurorial të Kosovës, për të rritur qëndrueshmërinë institucionale të dy Këshillave nevojiten angazhime të mëtejme.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme dhe Paneli për Ankesa i Agjencisë Kosovare të Pronës kanë vazhduar me gjykimin e lëndëve me shpejtësinë e tyre të rregullt. Të dy këto institucione kanë lëndë të grumbulluara, por numri i lëndëve të grumbulluara i Dhomës është shumë më i madh (nëntë herë më i madh se sa shkalla vjetore e lëndëve të zgjidhura), prandaj është e pamundur të vlerësohet se kur ky numër do të zvogëlohet deri në një nivel të menaxhueshëm. Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme është në proces të përmirësimit të brendshëm të performancës së saj. E ardhmja e Panelit për Ankesa të Agjencisë Kosovare të Pronës do të përcaktohet nga kapaciteti i kësaj Agjencie për t'ua dorëzuar vendimet fillestare të saj palëve që janë larguar nga Kosova, me qëllim që ato të mund të vendosin nëse do të ankohen apo jo; përndryshe Paneli i Ankesave mbase do të duhet të ekzistojë përgjithmonë.

Ndërkohë, Shërbimi Korrektues i Kosovës ka bërë progres të vogël në zhvillimin e tij drejt standardeve të BE-së. Ndërhyrjet e vazhdueshme e pengojnë funksionimin e pavarur të këtij institucioni, veçmas në lidhje me trajtimin e të burgosurve të profilit të lartë që janë nën përkujdesjen e tij. Potenciali që të burgosurit e radikalizuar të bëhen me ndikim në ambientet korrektuese vazhdon të jetë shqetësim, i cili kërkon përgjigje serioze në bashkëpunim të ngushtë me agjencitë e tjera të zbatimit të ligjit.

Zbatimi i marrëveshjeve për regjistrimin civil, lirinë e lëvizjes, MIK dhe integrimin e drejtësisë, të lidhura në kuadër të Dialogut të lehtësuar nga BE-ja, ka qenë i ngadaltë dhe jo konsekuent. Ky zbatim është vonuar edhe më shumë për shkak të zgjedhjeve parlamentare të jashtëzakonshme të mbajtura në Serbi dhe në Kosovë. Në anën tjetër, Agjencia për Regjistrimin Civil i ka hapur zyrat e reja në të katër komunat veriore në dhjetor 2016, me çka e ka lehtësuar lëshimin e dokumenteve të gjendjes civile (si letërnjoftimet dhe pasaportat) për popullatën në veri të Kosovës. Megjithatë, krijimi i Zyrave të Gjendjes Civile dhe miratimi i Udhëzimeve Administrative të domosdoshme për ta lehtësuar regjistrimin e popullatës dhe lëshimin e dokumenteve të gjendjes civile ka mbetur pezull. Lidhur me avancimin e marrëveshjes për lëvizjen e lirë në veri të Kosovës nuk është bërë ndonjë progres i konsiderueshëm meqë ende nuk janë ndërtuar ambientet dhe infrastruktura e nevojshme për regjistrimin e automjeteve në sistemin e Kosovës. Në muajin shkurt përfundimisht kanë filluar punët ndërtimore në njërin prej gjashtë Pikë-kalimeve të përbashkëta të përhershme ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, që e ka përsipër Prishtina. Në ndërkohë, nuk kanë filluar ende ndërtimet për tri Pikë-kalimet e përbashkëta të përhershme që i ka përsipër Beogradi, si dhe për dy të tjera që i ka përsipër Prishtina. Data 10 janar 2017 për fillimin e integrit të drejtësisë në veri të Kosovës ka kaluar pa asnjë zhvillim të bërë lidhur me këtë. Ndërsa të dy palët kanë treguar gatishmëri teknike për ta filluar këtë proces, vetë integrimi nuk është bërë asnjëherë dhe që prej atëherë është shtyrë.

Përderisa i kanë bërë një vlerësim punës së bërë gjatë vitit të kaluar, aktorët kryesorë të Bordit të Përbashkët Bashkërendues për Sundimin e Ligjit vazhdojnë të jenë të përkushtuar për ta zhvilluar edhe më tej sektorin e sundimit të ligjit në përputhje me standardet evropiane dhe praktikat më të mira, në

bazë të kriterëve të përgjithshme të përcaktuara për procesin e përafrimit të Kosovës me BE-në. Duke e pasur këtë parasysh, familja e BE-së u bën thirrje institucioneve kosovare që të vazhdojnë të marrin përsipër sa më shumë përgjegjësi për ndërtimin e një sistemi të sundimit të ligjit i cili është i qëndrueshëm, llogaridhënës dhe i pavarur. Familja e BE-së është e gatshme t'i ndihmojë institucionet kosovare sa herë që kjo është e domosdoshme, apo kur kërkohet nga ata.



BORDI I PËRBASHKËT BASHKËRENDUES PËR SUNDIMIN E LIGJIT

MARRËVESHJE KOMPAKTE 3

Institucionet kosovare për sundimin e ligjit, Shefi i Zyrës së BE në Kosovë/ Përfaqësuesi Special i BE dhe Misioni EULEX Kosova,

Duke i theksuar arritjet nga zbatimi i Marrëveshjes Kompakte 2 të nënshkruar më 14 maj 2015 të mbikëqyrura nga Bordi i Përbashkët Bashkërendues për Sundimin e Ligjit (BPBSL);

Duke e pranuar nevojën që autoritetet kosovare të bashkëpunojnë në mënyrë efektive me Misionin EULEX Kosova dhe PSBE/Zyrën e BE për arritjen e progresit të mëtejshëm në sektorin e sundimit të ligjit drejt arritjes së synimeve të Marrëveshjes Kompakte dhe përmbushjes së aspiratave të Kosovës për anëtarësim në BE;

Duke e theksuar zotimin e institucioneve kosovare për sundimin e ligjit për t'i zbatuar strategjitë dhe planet ekzistuese të tyre fuqizimin e mëtejshëm të sundimit të ligjit dhe për të punuar me PSBE/Zyrën e BE dhe EULEX Kosova për avancimin e agjendës së përbashkët;

Duke e theksuar zotimin e institucioneve kosovare për sundimin e ligjit për të shënuar progres të mëtejshëm drejt qëndrueshmërisë dhe llogaridhënies, si dhe për të zhvilluar dhe fuqizuar një sistem të pavarur dhe shumetnik të drejtësisë dhe një polici dhe doganë shumetnike të lira nga ndërhyrja politike dhe korrupsioni, që i respektojnë të drejtat e njeriut dhe që i përmbahen standardeve të pranuar ndërkombëtarisht dhe praktikave më të mira evropiane;

Duke e ripohuar zotimin e tyre të përbashkët për të punuar në kuadër të kornizës së përgjithshme të politikave të BE-së të përcaktuara në Procesin e Stabilizimit dhe Asociimit me Kosovën;

Duke e ripohuar gatishmërinë për t'i kontribuar normalizimit të marrëdhënieve mes Prishtinës dhe Beogradit dhe për të përparuar me zbatimin e marrëveshjeve të bëra deri më tani gjatë dialogut të lehtësuar nga BE-ja, si dhe të gjitha marrëveshjeve të tjera të ardhshme nga fusha e sundimit të ligjit;

Duke e pasur parasysh përputhshmërinë e plotë të programeve të asistencës së Bashkimit Evropian për Kosovës me objektivat e përgjithshme, synimet konkrete dhe aktivitetet specifike të parapara në këtë *Marrëveshje Kompakte*;

pajtohen si në vijim:

1. Institucionet e Kosovës, të ndihmuara nga Bashkimi Evropian, *mes tjerash* edhe nga EULEX Kosova dhe me anë të projekteve nga Instrumenti i PSBE për para anëtarësim (IPA) dhe programet përcjellëse për mbështetje, e përsërisin zotimin e tyre për këto

Objektiva të përbashkëta të përgjithshme në fushën e sundimit të ligjit:

- 1.) Fuqizimi i policisë, doganës, institucioneve korrektuese dhe gjyqësore në mbarë territorin e Kosovës, për të mirën e të gjitha komuniteteve dhe të sigurojnë qëndrueshmërinë e këtyre institucioneve në trajtimin e përgjegjësive të tyre;
- 2.) Rritja e kapaciteteve të institucioneve kosovare për sundimin e ligjit për trajtimin e krimeve ndëretnike, krimeve të rënda dhe të organizuara dhe të korrupsionit, në veçanti përmes sistemit të drejtësisë penale;
- 3.) Ngritja e llogaridhënies së të gjitha institucioneve për sundimin e ligjit duke i zhvilluar më tej kapacitetet dhe kompetencën e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe Inspektoratit Policor të Kosovës, si dhe të strukturave të tjera përkatëse të brendshme, që t'i marrin përsipër në tërësi rolet e tyre në përputhje me ligjin;

- 4.) Konsolidimi i kapaciteteve menaxhuese strategjike, operative dhe organizative të institucioneve kosovare për sundimin e ligjit në drejtim të avancimit të zbatimit të legjislacionit, strategjive dhe planeve përkatëse të veprimit, si dhe përmirësimit të mëtejme të ligjeve që kanë të bëjnë me sundimin e ligjit në Kosovë;
- 5.) Inkurajimi i shkallës më të lartë të përfshirjes etnike dhe barazisë gjinore në institucionet kosovare për sundimin e ligjit;
- 6.) Përmirësimi i reagimit të institucioneve kosovare për sundimin e ligjit ndaj shqetësimeve të ngritura shpesh nga ana e pakicave në lidhje me sigurinë publike, qasjen dhe transparencën;
- 7.) Fuqizimi i bashkëpunimit ndërinstitucional ndërmjet organeve të prokurorisë dhe atyre për zbatimin e ligjit duke e mundur një nivel më të lartë të komunikimit ndërmjet këtyre institucioneve;
- 8.) Ngritja e kapaciteteve të institucioneve përkatëse për trajtimin e kërkesave pronësore të pazgjidhura;
- 9.) Zhvillimi i mëtejme i sistemit të Kosovës për mbrojtjen e dëshmitarëve; përtej Udhërrëfyesit të zbatuar;
- 10.) Fuqizimi i kapaciteteve të Prokurorisë Speciale të Kosovës (PSRK) për t'i ndjekur krimet e luftës;
- 11.) Avancimi i shërbimeve mjeko-ligjore në Kosovë dhe fuqizimi i kapaciteteve të Institutit të Mjekësisë Ligjore si një agjenci e pavarur;
- 12.) Zbatimi i marrëveshjeve të arritura në kuadër të dialogut të lehtësuar nga BE-ja, përfshirë shfrytëzimin e zyrës së PSBE për lehtësimin e kërkesave për ndihmë juridike reciproke.

2. Palët nënshkruese do të punojnë në bazë të Veprimeve dhe Udhërrëfyesve të Marrëveshjes Kompakte duke u fokusuar në fushat prioritare të identifikuara, të cilat i përcaktojnë aktivitetet specifike dhe synimet konkrete me rezultate të matshme në përputhje me objektivat e përgjithshme të përbashkëta në fushën e sundimit të ligjit.

3. Si pjesë e përpjekjeve për përmbushjen e këtyre objektivave të përgjithshme të përbashkëta në fushën e sundimit të ligjit, Shefi i Zyrës së BE në Kosovë/PSBE, Shefi i Misionit

EULEX Kosova, Ministrja e Drejtësisë, Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës, zotohen që të takohen rregullisht në Bordin e Përbashkët Bashkërendues për Sundimin e Ligjit për ta shqyrtuar përparimin e arritur dhe për të rënë dakord për veprime konstruktive, praktike dhe të bashkërenduara për zgjidhjen e pengesave dhe avancimin e çështjeve teknike, përfshirë në fushat prioritare si në vijim:

- i) Zbatimin e veprimeve/udhërrëfyesit nga Marrëveshja Kompakte;
- ii) Kushtet e mbetura që kanë të bëjnë me liberalizimin e vizave të theksuara në Raportin e katërt të Komisionit Evropian të datës 4 maj 2016 për progresin e Kosovës në përmbushjen e kushteve për udhërrëfyesin për liberalizimin e vizave;
- iii) Legjislacionin lidhur me sundimin e ligjit;
- iv) Vazhdimësinë e ofrimit të shërbimeve në fushën e sundimit të ligjit përtej mandatit aktual të EULEX-it;
- v) Prioritetet e reformave të renditura në rishikimin e sektorit të sundimit të ligjit në Kosovë.

4. Institucionet kosovare, PSBE/Zyra e BE dhe EULEX Kosova e ritheksojnë zotimin e tyre të fuqishëm për tejkalimin e zbrazëtirave të identifikuar dhe për caktimin e burimeve të nevojshme dhe për përqendrimin e punës së tyre drejt përmbushjes së objektivave të përgjithshme të përbashkëta nga fusha e sundimit të ligjit që janë përcaktuar në këtë Marrëveshje Kompakte.

Prishtinë, më 7 dhjetor 2016

POLICIA & DOGANA



POLICIA NË KOMUNITET

Metodologjia e punës policore në komunitet është pranuar mirë në Kosovë. Mbështetja institucionale është siguruar nga nivelet më të larta në formën e Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit për Sigurinë në Komunitet për periudhën 2017-2021, të përgatitura nga Ministria e Punëve të Brendshme. Ky plan synon të përmirësojë sigurinë e komunitetit duke fuqizuar mjedisin ligjor dhe institucional, si dhe bashkëpunimin ndërmjet banorëve, institucioneve vendase dhe ndërkombëtare. Aty parashihet organizimi i takimeve mujore të Grupit Drejtues për Sigurinë në Komunitet për të diskutuar progresin dhe sfidat gjatë zbatimit të këtij plani.

Po ashtu, policia në komunitet ka mbështetje dhe përkushtim të konsiderueshëm në të gjitha radhët e Policisë së Kosovës (PK). PK-ja ka përgatitur Strategjinë e saj të tretë për Policinë në Komunitet dhe Planin e Veprimit për periudhën 2017-2021, kurse plani për periudhën paraprahe është zbatuar mjaft mirë – 18 prej 20 detyrave të parapara janë përfunduar me sukses. Gjatë rishikimit të parë gjashtë mujor të planit 2017-2021, është raportuar një progres i mirë në zbatimin e detyrave të caktuara, në veçanti sa i përket organizimit të 180 forumeve për siguri në tërë Kosovën, si dhe rishikimit dhe ndryshimit të Procedurave Standarde të Operimit në lidhje me Strategjinë e Policisë në Komunitet.

Një element i rëndësishëm i policisë në komunitet është krijimi i dialogut ndërmjet autoriteteve, policisë dhe vetë komunitetit. Ky dialog realizohet nëpërmjet forumeve të ndryshme të sigurisë. Këshillat Komunale për Sigurinë në Komunitet drejtohen nga kryetarët e komunave dhe aty marrin pjesë policia dhe një varg aktorësh të komunitetit. Këto këshilla janë krijuar në 34 prej 38 komunave në Kosovë, kurse pritet të formohen edhe në veri të Kosovës (në komunat e Leposaviqit, Mitrovicës Veriore, Zubin Potokut dhe Zveçanit). Në Këshillat Lokale për Sigurinë Publike marrin pjesë PK-ja dhe përfaqësuesit e komuniteteve; ata synojnë që të adresojnë problemet në ndonjë komunitet lokal të caktuar. Deri në qershor 2017 funksiononin gjashtëdhjetë e një këshilla të tilla. Po kështu janë formuar edhe 35 Ekipet e Sigurisë për Veprim në Komunitet, që janë mekanizma vullnetarë që synojnë përmirësimin e komunikimit ndërmjet komunitetit dhe policisë.

Përderisa zotimet janë të mëdha, zbatimi i plotë dhe efektiv i konceptit të policisë në komunitet kërkon fonde shtesë për pajisje dhe automjete, si dhe rritjen e numrit të personelit që punon në nivel të stacioneve policore.

Policia në komunitet është strategji policore që përqendrohet në ndërtimin e lidhjeve nga ana e policisë me komunitetet e tyre, si dhe në adresimin e shqetësimeve të sigurisë publike duke bashkëpunuar në mënyrë proaktive dhe të ngushtë me ta. Aty përfshihen funksionet themelore policore të parandalimit të krimeve, hetimet, rendi dhe qetësia publike dhe operacionet e sigurisë.

MARRËVESHJET PËR BASHKËPUNIM POLICOR

PK-ja ka arritur progres të mirë në bashkëpunimin e saj me agjenci të ndryshme të zbatimit të ligjit jashtë Kosovës. Ndërmjet tetorit 2016 dhe qershorit 2017, numri i përgjithshëm i marrëveshjeve teknike, dypalëshe dhe shumëpalëshe për bashkëpunim policor është rritur prej 70 në 74, me marrëveshjet e arritura në këto fusha:

Bashkëpunimi i PK-së me agjencitë e zbatimit të ligjit në nivel ndërkombëtar është shumë i rëndësishëm për përmirësimin e efektivitetit të saj në luftimin e krimeve trans-nacionale. Meqë Kosova ende nuk është pjesë e ndonjë organizate të madhe ndërkombëtare për zbatimin e ligjit, si EUROPOL-i ose INTERPOL-i, krijimi i marrëveshjeve dypalëshe dhe shumëpalëshe dhe dialogut ndërkufitar i ndihmon Kosovës që të jetë më shumë e angazhuar në fushën e krimeve trans-nacionale.

- 27 marrëveshje bashkëpunimi në fushën e hetimeve të arritura me 17 vende, përfshirë disa vende anëtare të BE-së, SHBA-ve dhe Zvicrën;
- 9 Memorandume të Mirëkuptimit në fushën e operacioneve, nga të cilat 8 janë me Shqipërinë dhe 1 me Kroacinë;
- 28 marrëveshje bashkëpunimi në fushën e Policisë së Kufirit, 15 nga të cilat me Shqipërinë;
- 10 marrëveshje bashkëpunimi të arritura me EULEX-in.

PK-ja ka zotësi të plotë për t'u angazhuar me palët e treta shtetërore për të negociuar marrëveshje të tjera, dhe së këndejmi nuk ka nevojë më për ndihmë në lehtësimin e marrëveshjeve të ardhshme. Megjithatë sfida kryesore e Kosovës në këtë fushë është

anëtarësimi në EUROPOL dhe INTERPOL, kurse kjo gjë nuk ka qenë e mundur të bëhet deri më tani për shkak të statusit ligjor të saj. Kjo ndikon në kapacitetet dhe efektivitetin e PK-së për të luftuar krimin e organizuar trans-nacional. Për këtë arsye, EULEX-i vazhdon të menaxhojë kontaktet me EUROPOL-in kurse Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë bën lehtësimin në çështjet policore me INTERPOL-in.

FUNKSIONIMI I POLICISË NË BAZË TË ANALIZAVE DHE TË DHËNAVE

Modeli i funksionimit të policisë në bazë të analizave dhe të dhënave (FPADH) si një qasje metodologjike për analizimin e informatave nga PK vazhdon të jetë në fazat e hershme të shfrytëzimit të tij. PK-ja ka miratuar një koncept relativisht adekuat të FPADH-së, por i mungojnë kapacitetet njerëzore dhe udhëzimet specifike menaxhuese për të siguruar raportim konstant dhe të përditësuar. Edhe pse gjatë viteve të kaluara EULEX-i ka ofruar trajnime, raportet e inteligjencës të përgatitura nga PK-ja janë në nivelin e pritur dhe duhet të përmirësohen si në anën sasiore, ashtu edhe atë përmbajtësore. Sistemi Informatik i Policisë së Kosovës është shtrirë në tërë organizatën, kurse trajnimet plotësuese janë të domosdoshme me qëllim që personeli përgjegjës të jetë në gjendje ta shfrytëzojë plotësisht këtë sistem.

PK-ja ka zhvilluar metodat e saj të FPADH-së në kuadër të saj dhe ka publikuar manualin e rishikuar të FPADH-së në vitin 2016. Pasi që proceset aktuale të FPADH-së nuk janë duke u shfrytëzuar si mjete për vendim-marrje, miratimi i procesit të rishikuar do të lejonte ndërtimin e një sistemi plotësisht funksional, si dhe për identifikimin më të mirë të veprave si krimet e urrejtjes ose dhuna në baza seksuale dhe gjinore.

Aktualisht ekziston një numër i pamjaftueshëm i personelit të ngarkuar me detyra të FPADH-së, andaj disa informacione vonohen apo nganjëherë nuk raportohen të plota. Gjithashtu, analistëve u caktohen edhe detyra tjera, ose ndodh që t'u mungojnë disa nga përgatitjet e domosdoshme. Në disa stacione, komandantët e FPADH-së nuk kanë oficerë në dispozicion për të mbledhur informacione për shkak se ata udhëzohen tërësisht në detyra tjera.

Sistemi Informatik i Policisë së Kosovës, si dhe baza e avancuar e të dhënave për menaxhimin e rasteve, është një mjet i rëndësishëm për zbatimin e suksesshëm të FPADH-së, pasi që është shumë i rëndësishëm për mbledhjen, regjistrimin dhe analizimin e informacioneve të inteligjencës. Oficerët e ngarkuar me përdorimin e këtij sistemi ekzistojnë në nivelin e stacioneve qendrore, rajonale dhe lokale të policisë, ndërsa pajisjet e TI-së dhe softuerët e domosdoshëm janë adekuatë dhe të kohës së fundit. Mirëpo, shumë oficerë në nivelin e stacioneve kanë nevojë për trajnime shtesë për përdorimin e këtij sistemi, kurse në shumë raste edhe për njohuri themelore të TI-së. Nga 1,800 oficerë të Policisë së Kufirit të cilëve u është dhënë qasja dhe fjalëkalimet, është vlerësuar se vetëm 1,100 prej tyre ishin në gjendje të hynin në sistem. Për ta përshpejtuar zbatimin e plotë të këtij sistemi, EULEX-i ka rekomanduar përfshirjen e trajnimit përkatës për TI-në në plan-programin e Akademisë Policore, dhe thjeshtësimin e procedurës së autorizimit për përdorimin e Sistemit Informatik.

Raportimi i bazuar në të dhënat e inteligjencës vazhdon të jetë në nivel të ulët përkundër përpjekjeve të bëra nga EULEX-i në vitin 2015 dhe 2016 për ta trajnuar PK-në në pesë nga tetë rajonet policore. Vlerësimet bëjnë të ditur se ky projekt kishte ndikim të përkohshëm dhe jokonsekuent pasi përdorimi i FPADH-së ka shënuar rënie gjatë vitit të kaluar.

FPADH është qasje strategjike dhe sistematike për zgjidhjen e krimeve. Metodologjia e FPADH-së është që në mënyrë analitike të deshifrohen të dhënat kriminale në mënyrë që të përcaktohen resurset më të mira që do të shfrytëzohen për të frenuar dhe eliminuar krimin.

NJËSITË E SPECIALIZUARA DHE EKIPET PËR REAGIM TË SHPEJTË

Divizioni i Njësive të Specializuara të PK-së e ka vazhduar performancën e tij të lartë në operacione të ndryshme, si të atyre për kontrollin e turmave dhe trazirave, operacione për ruajtjen e rendit dhe qetësisë, sigurinë e personaliteteve të rëndësishme dhe operacione speciale policore. Nën-njësitë e këtij Divizioni (përveç Njesisë K-9) në përgjithësi janë të pajisura mjaftueshëm dhe të trajnuara mirë, duke i kryer detyrat në të njëjtin nivel sikur njësitë e ngjashme në vendet e BE-së. Në mars 2017, ky Divizion inicioi një propozim për riorganizimin e Njesisë për Operacione Speciale për të rritur efikasitetin dhe efektivitetin për t'u ballafaquar me kërcënimet terroriste dhe fenomene të tjera që ndikojnë në sigurinë dhe rendin e qetësinë publike. Me përkrahjen e EULEX-it, ky Divizion aktualisht është duke zhvilluar një doktrinë për menaxhimin e ngjarjeve të mëdha, me çka do të adresohen mangësitë e identifikuar.

Njësitë e Specializuara janë të vendosura afër Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës, i cili ndodhet 17 kilometra larg qendrës së Prishtinës, që sjell kohë të gjatë mbërritjeje në raste të reagimit ndaj situatave



urgjente në qytetin më të madh të Kosovës. Në pritje të largimit të Njesisë Portugeze në kuadër të Forcës për Kosovën (KFOR) nga kampi i saj në qendër të Prishtinës në fund të vitit 2016, PK-ja ka bërë kërkesë që ky kamp t'u jepet Njësive të Specializuara. Zhvendosja e kësaj Njësie më afër Prishtinës do ta shkurtonte dukshëm kohën e nevojshme për reagim në qytet, si dhe do t'i mundësonte kësaj njësie që të arrinte brenda një ore në cilindo qytet tjetër më të madh, pasi që ky kamp ndodhet pranë një kryqëzimi

kryesor të autostradave. Aftësia e Njësive të Specializuara për të reaguar shpejt është gjithmonë shumë e rëndësishme në punën e tyre, sidomos në rastet e incidenteve të rënda dhe atyre në zhvillim e sipër.

Përveç Njesisë për Operacione Speciale në kuadër të këtij Divizioni, ekziston edhe një formacion i dytë i njësive për reagim që ndodhen në Drejtoritë Regjionale të Policisë në tërë Kosovën, të cilat quhen Ekipe për Reagim të Shpejtë. Një vlerësim i iniciuar nga EULEX-i i bërë në shkurt 2017 ka gjetur mangësi shumë të mëdha në menaxhimin dhe pajisjet e këtyre njësive. Këtyre ekipeve shpesh herë u ngarkohen detyra që nuk janë paraparë në kuadër të fushëveprimit të punës së tyre, kurse në disa regjione atyre u mungojnë edhe pajisjet elementare. Në ndërkohë, komandantëve të caktuar në këto njësi u mungojnë aftësitë drejtuese të domosdoshme. PK-ja ka bërë pak progres në adresimin e këtyre dhe mangësi të tjera të identifikuar.


NJËSIA PËR TRASHËGIMINË FETARE DHE KULTURORE

Raportet për rastet e vjedhjes, zjarrvënies dhe vandalizimit të pasurisë në lokacionet e trashëgimisë fetare dhe kulturore janë regjistruar në një numër pak më të vogël krahasuar me vitin pararendës (shih grafikun më poshtë). Megjithatë numri dhe natyra e incidenteve tregojnë nevojën e vazhdueshme për t'i siguruar këto lokacione, si dhe për të siguruar patrullime efektive të Njesisë për Trashëgiminë Fetare dhe Kulturore në varreza, të cilat kanë qenë shpeshherë cak i vandalizimit dhe vjedhjes. Në të njëjtën kohë, niveli i incidenteve të raportuara në 24 lokacionet e mbrojtura nga kjo Njësi ka qenë i ulët, me vetëm katër incidente të regjistruara gjithsej gjatë periudhës raportuese. Kjo Njësi ka vazhduar të jetë në nivel të kënaqshëm të kryerjes së detyrave të saj, duke i realizuar ato me profesionalizëm dhe kompetencë.

Kundër kësaj Njësie është paraqitur vetëm një ankesë nga një përfaqësues i Kishës Ortodokse Serbe gjatë periudhës raportuese. Për këtë janë bërë hetime të cilat kanë përfunduar me përjashtimin e një pjesëtari të PK-së. Ky incident i izoluar nuk ka ndikuar në bashkëpunimin ndërmjet Kishës dhe PK-së, përkundrazi ishte shembull i qasjes serioze dhe profesionale të kësaj Njësie në adresimin e këtyre incidenteve. Komandanti i kësaj Njësie në mënyrë proaktive ka vazhduar ta përmirësojë bashkërendimin e aktiviteteve të kësaj Njësie me të gjitha njësitë organizative të PK-së, si dhe për zhvillimin dhe përmirësimin e mëtejshëm të bashkëpunimit me përfaqësuesit e të gjitha komuniteteve fetare.

Nga krijimi i saj në vitin 2013, kjo Njësi i ka ndërtuar kapacitete të plota vepruese dhe është ballafaquar vetëm me incidente sporadike në lokacionet të cilat i ka siguruar gjatë viteve të kaluara. Andaj, kësaj njësie i nevojitet vetëm kontributi i EULEX-it me anë të monitorimit, mentorimit dhe këshillimit.

Njësia e PK-së për Trashëgiminë Fetare dhe Kulturore është krijuar në mars 2013 si rezultat i Dialogut të lehtësuar nga BE-ja. Kjo njësi me 200 pjesëtarë bën sigurimin e 24 lokacioneve të trashëgimisë fetare dhe kulturore në Kosovë, që kryesisht i takojnë Kishës Ortodokse Serbe, me prani të përhershme të policëve në pika statike. Këshilltarët e EULEX-it e kanë mbështetur krijimin dhe zhvillimin e kësaj njësie përmes monitorimit, mentorimit dhe këshillimit të vazhdueshëm.



Grafiku: Incidentet e raportuara në lokacionet e trashëgimisë fetare dhe kulturore që nuk janë në kuadër të fushëveprimit të Njesisë për Trashëgiminë Fetare dhe Kulturore

POLICIA E KOSOVËS NË PJESËN VERIORE TË KOSOVËS

PK në veri të Kosovës vazhdon të funksionojë në një mjedis politik kompleks, ku shumë faktorë të mbetur të brendshëm dhe të jashtëm e pengojnë atë që t'i zhvillojë më tej praktikën policore të saj – ndikimet e vazhdueshme politike dhe qasja e kufizuar në mekanizmat gjyqësorë në veri të Kosovës

Si rezultat i Marrëveshjes së Brukselit të vitit 2013, është krijuar një Drejtori Regjionale e veçantë e Policisë në veri të Kosovës, duke i vendosur nën komandën e drejtpërdrejtë të saj stacionet lokale të policisë në katër komunat me shumicë serbe në veri të Kosovës. Në ndërkohë, edhe 286 ish-pjesëtarë tjerë të MUP-it (Ministrisë së Brendshme të Serbisë) janë integruar në forcën e PK-së që funksionon në këto komuna. Drejtorja Regjionale e Policisë Mitrovica Veri është funksionalizuar në mars 2014 dhe prej atëherë është mbështetur vazhdimisht në mënyrë të strukturuar nga këshilltarët policorë të EULEX-it përmes mentorimit, monitorimit dhe këshillimit.

vazhdojnë të jenë probleme të përgjithshme. Pa i tejkaluar këto pengesa, Komanda Regjionale Veri do të vazhdojë të jetë e kufizuar në aftësitë e saj për të formësuar angazhimin e saj dhe për t'u zhvilluar në përputhje me standardet evropiane.

PK-ja ka vazhduar të ofrojë kryesisht shërbime të natyrës reaguese për qytetarët në veri të Kosovës. Derisa në një numër rastesh këshilltarët policorë të EULEX-it e kanë inkurajuar PK-në për një qasje më proaktive dhe lidhur me këtë kanë vërejtur disa hapa pozitivë, PK-ja duhet të punojë edhe më tej në këtë fushë. Kundërpërgjigja e PK-së ndaj përleshjeve të shpeshta ndërmjet grupeve të të rinjve shqiptarë dhe serbë të Kosovës në veri të Mitrovicës gjatë gjysmës së parë të vitit 2017 e ilustron më së miri qasjen aktuale reaguese të saj. Këto incidente kanë filluar të ndodhin në shkurt dhe prej atëherë kanë vazhduar pothuaj për çdo javë, duke u bërë burim shqetësimi për banorët e qytetit. PK-ja u është përgjigjur këtyre incidenteve duke e shtuar praninë e saj, si dhe duke dërguar patrulla shumë-etnike dhe policë në

proba civile në zonat ku incidentet kanë ndodhur më së shpeshti. Një qasje më proaktive e PK-së do të përfshinte: krijimin e një grupi pune specifik për t'u marrë me rastet e ndërlydhura; rritjen e bashkëpunimit dhe kontaktit me prokurorinë publike; informimin më efektiv të banorëve duke i shfrytëzuar mediat më mirë dhe duke bashkëpunuar më ngushtë me komunën.

Bashkëpunimi ndërmjet Drejtorive Regjionale të PK-së Mitrovica Jug dhe Mitrovica Veri dhe stacioneve përkatëse të tyre, si dhe ndërmjet Drejtorisë Regjionale Veri me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë në Prishtinë ka nevojë për përmirësim të mëtejshëm. Gjatë periudhës raportuese kanë ndodhur një numër i konsiderueshëm i ngjarjeve dhe incidenteve të ndjeshme politike, siç janë punimet për rivitalizimin e urës kryesore, largimi i "murit" në afërsi të hyrjes së urës në veri të Mitrovicës, dhe vizita e Përfaqësueses së Lartë të BE-së/Nënkryetares Mogherini në urën kryesore. Natyra dhe shpeshtësia e këtyre zhvillimeve kanë kërkuar kontakte dhe bashkërendim të ngushtë ndërmjet stacioneve policore Mitrovica Veri dhe Mitrovica Jug – gjatë të cilave marrëdhënia ndërmjet tyre është zhvilluar në mënyrë pozitive me kalimin e kohës. Megjithatë, kontakti edhe më tej bëhet në baza *ad hoc*, në vend të takimeve të mirëfillta të rregullta dhe për numër të pakufizuar të temave. Ndryshe nga kjo, marrëdhëniet ndërmjet Komandës Regjionale Veri të PK-së me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë në

Prishtinë janë përkeqësuar. Niveli qendror në disa raste e ka dërguar personelin e tij në veri të Kosovës pa i njoftuar udhëheqësit e PK-së në atë regjion, kurse Drejtoria Regionale e Policisë nuk e ka zbatuar një urdhër të drejtpërdrejtë të nivelit qendror. Mungesa e dukshme e besimit ndërmjet Komandës Regionale Veri të PK-së me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë në Prishtinë është pengesë për progresin e mëtejshëm.

Në një aspekt më pozitiv, gjatë planifikimit të operacioneve, siç ishte ai për largimin e “murit” në afërsi të hyrjes së urës në veri të Mitrovicës në janar 2017, apo para zgjedhjeve në gjysmën e parë të vitit 2017, PK-ja në veri të Kosovës ka përgatitur vazhdimisht plane operative adekuate. Këto plane janë përgatitur në përputhje me udhëzimet e përgjithshme të dhëna nga niveli qendror, duke caktuar numër të duhur të personelit dhe duke identifikuar lokacionet për operacionet e planifikuara. Ekziston hapësirë e caktuar për përmirësime lidhur me hartimin e këtyre planeve pasi ato vazhdojnë të jenë shumë të përgjithshme, me referenca të tepërta në ligjet e zbatueshme, në vend që të përqendrohen në përshkrimin e vetë ndërhyrjes së planifikuar dhe detyrave që duhet të kryhen.



Foto: Drejtoria Regionale e Policisë – Mitrovica veriore

INSPEKTORATI POLICOR I KOSOVËS

Meqë Inspektorati Policor i Kosovës (IPK) është shumë i rëndësishëm për llogaridhënien e policisë, ai ka punuar për të arritur kapacitete të plota funksionale sa u përket burimeve njerëzore dhe financiare. Pas shkurtimeve buxhetore gjatë viteve të kaluara, IPK-ja ia ka dalë të sigurojë rritjen e buxhetit të saj për

Inspektorati Policor i Kosovës (IPK) është agjenci ekzekutive e krijuar në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme. Ai është i pavarur nga PK-ja dhe e ka për detyrë që të sigurojë një shërbim policor të përgjegjshëm, demokratik dhe transparent. IPK i heton zyrtarët e PK-së të cilët dyshohen se janë përfshirë në vepra penale ose incidente disiplinore të profilit të lartë si korrupsioni apo shkeljet e të drejtave të njeriut. Përderisa kjo agjenci është dashur të jetë plotësisht funksionale në qershor 2011, IPK vazhdon të ballafaqohet me shumë sfida për ta arritur funksionalitetin e plotë të saj.

vitin 2017. Kjo i ka mundësuar IPK-së të punësojë dhe trajnojë katër drejtorë departamentesh, si dhe 23 pjesëtarë shtesë të personelit të tij, duke e adresuar kështu mungesën prej 20% të personelit në kuadër të IPK-së. Për më tepër, ristrukturimi organizativ i ndërmarrë nga Kryeshefi Ekzekutiv i IPK-së, si dhe nënshkrimi dhe hyrja në fuqi e dy Udhëzimeve Administrative¹, kanë krijuar hapësirën për shpalljen e këtyre konkurseve dhe shkrirjen e dy departamenteve të IPK-së në një. Ndërsa procesi i përzgjedhjes së katër drejtorëve të departamenteve është përmbyllur në mars 2017, punësimi i 23 pjesëtarëve të personelit është shtyrë për më vonë, për shkak të vonesave në ndarjen e buxhetit. Duke pasur parasysh se tërë rritja e buxhetit për vitin 2017 është shpenzuar për të punësuarit e rinj dhe trajnime, është shtyrë edhe faza e dytë e regjionalizimit, që nënkupton krijimin e tri

zyrave regjionale shtesë. Në ndërkohë zyrat regjionale të IPK-së që janë hapur në veri të Mitrovicës, Gjilan dhe Prizren gjatë vitit 2015 janë duke funksionuar me vetëm nga një zyrtar secila, me çka puna e tyre është e kufizuar vetëm në pranimin e ankesave. Po ashtu, këto zyra nuk janë të pajisura sa duhet dhe nuk kanë automjete zyrtare.

Kapacitetet funksionale të IPK-së varen shumë nga bashkëpunimi i saj me PK-në, prokuroritë dhe me gjyqësorin. Përmirësimi i bashkëpunimit të saj me këto institucione ka qenë thelbi i aktiviteteve të IPK-së. Bashkëpunimi ndërinstitucional ndërmjet IPK-së dhe PK-së ka qenë gjithmonë problematik dhe relativisht i dobët. Një shembull i freskët i kësaj është mospajtimi i tyre lidhur me një grup prej 59 zyrtarësh policorë të arrestuar në dhjetor 2016, të dyshuar për keqpërdorim të detyrës zyrtare dhe mitë marrje. Në këtë rast, PK-ja kishte hezitur të ndërmerre menjëherë masa disiplinore kundër komandantëve të katër stacioneve përkatëse ku ishin të punësuar këta zyrtarë policorë. Në fund, PK-ja i transferoi këta katër zyrtarë të lartë prej këtyre stacioneve në mars 2017, por vetëm pasi në këtë çështje kishte ndërhyrë bashkësia ndërkombëtare. Po ashtu, një shqetësim i përgjithshëm është edhe mosgatishmëria e PK-së për të dhënë informata lidhur me masat ndëshkimore të shqiptuara kundër këtyre zyrtarëve të PK-së, të cilët janë shpallur fajtorë nga gjykatat si rezultat i hetimeve të bëra nga IPK-ja. Në ndërkohë, bashkëpunimi i IPK-së me prokuroritë dhe gjyqësorin nuk është ende në nivelin e


¹ Udhëzimi Administrativ (UA) Nr. 15/2015 (Ministria e Punëve të Brendshme) për *Procedurat lidhur me punën e të punësuarve të IPK-së dhe kriteret për punësim* si dhe UA Nr. 02/2011 për *Strukturën Organizative të Brendshme të IPK-së*.

dëshiruar. Prokurorët në veçanti hezitojnë t'i ndjekin rastet e zyrtarëve të nivelit të lartë të PK-së, kurse numri i aktgjykimeve të nxjerra nga gjykatat në bazë të hetimeve të IPK-së është shumë i vogël. Prandaj gjykatat duhet t'u japin më shumë prioritet sesa tani rasteve të IPK-së, kurse vëmendje e veçantë u duhet kushtuar veprave të rënda të kryera nga zyrtarët policorë, si dhe zbatimit të plotë të aktgjykimeve.

Procedura për ndryshimin e *Ligjit për Inspektoratin Policor të Kosovës* është ende e bllokuar. Ndryshimet e propozuara fillimisht kishin për qëllim të rregullonin dhe ndryshonin numrin e dispozitave dhe funksioneve të përcaktuara në ligj, në veçanti ato për llojet e punësimit në IPK. Edhe pse IPK-ja i kishte propozuar ndryshimet e reja në përputhje me rekomandimet e EULEX-it, e të cilat ishin miratuar nga Ministria e Punëve të Brendshme, ky projektligj nuk u përshi në Programin Legjislativ të Qeverisë për vitin 2017. Kjo bllokadë i ka ndërlikuar edhe procedurat për projekt-*Ligjin për pensionet e zyrtarëve policorë të Policisë së Kosovës dhe të punësuarve të Inspektoratit Policor të Kosovës me autorizime policore*, pasi që këto dy ligje kanë nevojë për harmonizim.

Pasi e ka vlerësuar të nevojshme rritjen e vetëdijesimit publik lidhur me IPK-në, kjo agjenci ka mbajtur disa punëtori dhe tryeza diskutimi në bashkëpunim me universitetet dhe organizatat joqeveritare në komunat në veri të Kosovës, në Gjilan dhe Prizren, ku ka sqaruar rolin dhe detyrat e IPK-së, mekanizmat e saj për ankesa dhe të drejtat e qytetarëve. Këto organizime kanë synuar përmirësimin e të kuptuarit të mandatit të IPK-së nga ana e publikut, pasi që ai shpesh herë ngatërrohet duke menduar se është pjesë e PK-së dhe jo si strukturë e pavarur në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme.


Në bazë të Raportit Vjetor të IPK-së për vitin 2016, janë regjistruar 1,362 ankesa për shkelje të mundshme nga ana e policisë, një rritje prej 9.2% nga viti 2015. Ky numër pritet të rritet në vitin 2017 si rezultat i organizimeve vetëdijesuese të mbajtura në tërë Kosovën. Prej këtyre ankesave të pranuar, IPK-ja ka ndërmarrë masat në vijim: 69 paraburgime, 99 rekomandime për pezullim nga puna dhe gjashtë rekomandime për transferim (shih grafikun më poshtë). Llojet e rasteve të hetuara më së shpeshti janë ato që ndërlidhen me shkaktimin e rrezikut në trafik, keqpërdorimin e pozitës zyrtare apo autoritetit, si dhe shkaktimin e lëndimeve të lehta trupore.



Grafiku: Masat dhe rekomandimet e IPK-së, 2012-2016

DOGANA E KOSOVËS DHE POLICIA KUFITARE E KOSOVËS

Dogana e Kosovës ka arritur një rekord të ri të arkëtimit të të hyrave në vitin 2016, që ishin 8.4% më të mëdha krahasuar me vitin 2015, ose pak më shumë se shifra e synuar për vitin 2016 e përcaktuar nga



Grafiku: Arkëtimi i të hyrave gjatë periudhës trevjeçare


e pasur parasysh se Dogana e Kosovës humbi gjithsej 48 milionë € në vitin 2016 si rezultat i nënshkrimit të Marrëveshjes për Stabilizim dhe Asociim² dhe vendimeve tjera lidhur me politikat fiskale.

Departamenti i Zbatimit të Ligjit në Doganën e Kosovës me njësitë e tij kundër kontrabandës, të inteligjencës dhe hetimit ka vazhduar të krijojë rezultate pozitive. Gjatë vitit 2016, Dogana e Kosovës paraqiti 80 akuza penale kundër 164 personave për shkelje doganore (shmangie të doganës me gjithsej 2.5 milionë €), si dhe zbuloi më shumë se 350 kilogramë të lëndëve narkotike. Po ashtu, është bërë edhe konfiskimi i mallrave, si 7.5 milionë cigare, 200 kilogramë duhan, 300 makina ilegale të lojërave, 30 automjete (shumica me targa të falsifikuara), si dhe janë zbuluar një numër i armëve të zjarrit. Përveç kësaj, Dogana e Kosovës ka shpartalluar tri grupe të organizuara kriminale me rreth 70 persona. Dogana e Kosovës, PK-ja dhe Administrata Tatimore e Kosovës kanë kryer operacione të përbashkëta, me çka kanë dëshmuar përmirësime të dukshme në praktikën e punës dhe profesionalizmin, në veçanti, të Departamentit të Doganës për Zbatimin e Ligjit. Për më tepër, puna e përbashkët e ndërmarrë me PK-në është tregues pozitiv i bashkëpunimit ndërmjet agjencive në luftimin e krimit ndërkufitar dhe atij të organizuar.


² Marrëveshja e Stabilizim Asociimit është paraparë që në mënyrë graduale të ndërtojë tregtinë e lirë ndërmjet Kosovës dhe vendeve anëtare të BE-së. Si efekt i drejtpërdrejtë i kësaj, të hyrat doganore pritet të zvogëlohen në baza vjetore për një periudhë pesëvjeçare.

Disa nga arritjet e theksuara në fushën e menaxhimit të kufirit në Kosovë janë shënuar në kontekstin e marrëdhënieve ndërkombëtare: Dogana e Kosovës është bërë anëtarja më e re e Organizatës Botërore të Doganave (*Anëtarja e 181^{të}*) në mars 2017. Për më shumë, pas nënshkrimit të një Marrëveshjeje Pune për krijimin e bashkëpunimit operacional ndërmjet FRONTEX-it dhe Kosovës në maj 2016, FRONTEX ftoi përfaqësuesit e Policisë së Kufirit të Kosovës të marrin pjesë si vëzhgues në operacione të përbashkëta. Në mars dhe prill 2017, Policia e Kufirit e Kosovës dërgoi dy zyrtarë të saj si vëzhgues në operacionin e përbashkët të FRONTEX-it në kufijtë e jashtëm të BE-së, kurse dy zyrtarë të Policisë së Kufirit të Kosovës nga Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës janë dërguar si vëzhgues në dy aeroporte ndërkombëtare të ndryshme të BE-së (Vjenë dhe Lubjanë).

FRONTEX është Agjencia Evropiane e Kufirit dhe Rojës Bregdetare, me mandat promovimin, bashkërendimin dhe zhvillimin e menaxhimit të kufirit në Evropë në përputhje me Kartën Evropiane për të drejtat themelore dhe konceptin e Menaxhimit të Integruar të Kufirit.



DREJTËSIA



MONITORIMI I RASTEVE TË PËRZGJEDHURA TË KOSOVËS

EULEX-i ka monitoruar rastet e përzgjedhura përmes tri kanaleve të ndryshme, ku janë përfshirë (1) 199 raste që EULEX-i ka dorëzuar tek homologët vendas mes periudhës korrik 2016 dhe qershor 2017; (2) 10 raste në lidhje me të cilat janë paraqitur ankesa të jashtme në EULEX; dhe (3) 38 raste të përzgjedhura në bazë të çështjeve tematike (gjinia, krime të urrejtjes, IPK). Rastet janë monitoruar nëpër shtatë gjykata themelore, në Prishtinë, Prizren, Mitrovicë, Ferizaj, Gjakovë, Gjilan, Pejë, në disa degë të gjykatave, dhe në Gjykatën e Apelit.

Gjatë monitorimit, këshilltarët e EULEX-it konstatuan prani të sfidave dhe parregullsive të caktuara që ndikojnë në sektorin e sundimit të ligjit në Kosovë dhe që vazhdojnë të përsëriten pavarësisht llojit të rasteve, shkallës së gjykatës, apo rajonit.

Sfida kryesore që vazhdon të jetë e pranishme shkaktohet nga vonesat në procedurat ligjore. Këto vonesa mund të ndodhin për një sërë arsyesh, ku përfshihen: caktimi me ngadalësi i rasteve, mos caktimi i seancave dëgjimore prej gjykatave brenda 15 ditëve – apo fare; shtyrja e seancave dëgjimore për afate të tjera për shkak të mungesës së avokatëve apo zëvendësimeve të prokurorëve në momentin e fundit; vonesat e pashpjeguara në dorëzimin e raporteve nga ekspertët ligjorë; mos vijimi i seancave dëgjimore nga ana e ekspertëve; rotacionet e gjyqtarëve dhe prokurorëve (për avancime apo arsye të tjera); dorëzimi i vazhdueshëm i rasteve pa u shënuar ndonjë progres; dhe shtyrja e rasteve për arsye teknike. Tek rastet penale, kur bëhen vonesa të konsiderueshme, vije deri tek parashkrimi, dhe si pasojë rastet mbyllen pa vendime. Kjo krijon situatë jo të mirë, që më së miri përmblihet në “drejtësia e vonuar është drejtësi e mohuar”.

Problem tjetër i vazhdueshëm janë regjistrat e pa mirëmbajtur të gjykatave, çka sjell vështirësi në gjetjen e lëndëve. Për shembull, në një rast, në regjistrin e Prokurorisë Themelore në Prishtinë këshilltarët e EULEX-it mundën të gjejnë vetëm tri prej 51 lëndëve që janë bartur së fundmi nga Prokuroria Speciale e EULEX-it në Kosovë (PSRK) tek homologët e tyre. Më tej, faqet që nuk përputhen dhe strukturimi i dosjes së lëndëve krijon vend potencial për ndërhyrje tek dokumentet. Sfidë tjetër vjen nga praktika e caktimit të numrit të ri lëndëve që kthehen për rigjykim, çka shpie në rritjen artificiale të numrit të lëndëve në pritje dhe, kështu, të numrit të përgjithshëm të lëndëve të grumbulluara.

Në disa raste këshilltarët kanë vërejtur mungesë të hapësirave nëpër objektet e gjykatave si për vetë gjykatat, ashtu edhe për qytetarët, dhe mungesë të orendive. Hapësirat dhe pajisjet e papërshtatshme mund të pengojnë efikasitetin dhe vendosjen e drejtësisë. Duhet të theksohet, megjithatë, se KGJK në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë ka bërë përpjekje të konsiderueshme gjatë viteve të fundit për përmirësimin dhe/apo zëvendësimin e objekteve të papërshtatshme, për shembull, përmes

Raste të caktuara që nuk janë më nën kompetencën e EULEX-it që nga viti 2014, apo që konsiderohen të ndjeshmërisë së kufizuar, janë kaluar nga gjyqtarët dhe prokurorët e EULEX-it tek autoritetet e Kosovës. Me qëllim të mbështetjes së autoriteteve të Kosovës për ruajtjen e cilësisë së procedurave dhe natyrës së pavarur të drejtësisë, EULEX ka marrë përsipër monitorimin e disa rasteve (jo të gjitha).

ndërtimit të objekteve të reja për Gjykatat Themelore në Ferizaj dhe Gjakovë. Gjendja e vështirë me objektet e gjykatave në rajonin e Mitrovicës vazhdon të jetë çështje e pazgjidhur.

Burim afatgjatë i shqetësimit kanë qenë shkeljet sistematike të *Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve Zyrtare* gjatë procedurave gjyqësore, ku gjykatat nuk arrijnë të sigurojnë shërbime të duhura të përkthimit për palët që nuk e flasin gjuhën shqipe. Kjo shpie në situata ku palës i shërbehen dokumente në gjuhën që nuk e kupton, por prapëseprapë i kërkohet që t'i nënshkruajë.

Një problem tjetër është trajtimi i mangët i krimeve që kanë potencial të jenë krime nga urrejtja. Në Kodin Penal të Kosovës ekziston një dispozitë e veçantë për krimet nga urrejtja si formë e rëndë e shkeljeve të tjera penale; megjithatë autoritetet prokuroriale dhe gjyqësore duken jo të gatshme që ta marrin parasysh motivin e urrejtjes tek krimet dhe, si rezultat, krimet që kanë potencial të jenë krime nga urrejtja nuk regjistrohen si të tilla dhe kështu shpien në statistika të gabuara.

Në fund, sektori i sundimit të ligjit vuan nga bashkërendimi i dobët mes institucioneve kyçe të tij (për shembull, policisë dhe prokurorisë) dhe nga pamjaftueshmëria e punonjësve administrativë apo mbështetës nëpër gjykata dhe prokurori.

Familja e BE-së ka zhvilluar komunikim të afërt me institucionet relevante të sundimit të ligjit, siç është Ministria e Drejtësisë, Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK), dhe Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK), për t'i adresuar këto sfida. Si aspekt pozitiv, megjithatë, duhet të theksohet se rastet e transferuara në lidhje me krimet e luftës autoritetet vendase i kanë procesuar me përpikëri dhe sipas standardeve më të larta.



KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS DHE KËSHILLI PROKURORIAL I KOSOVËS

Gjatë periudhës së raportimit, të dy Këshillat janë përballur me sfida të shumta në lidhje me përmbushjen e mandateve kushtetuese dhe ligjore të tyre. Në përgjithësi, KGJK dhe KPK duhet t'i rrisin kapacitetet dhe burimet për të funksionuar plotësisht të pavarura, me qëllim që të mënjanojë në mënyrë efektive perceptimet e ndërhyrjeve. Megjithatë, ka pasur edhe progres. Për shembull, në janar 2017 ka hyrë në fuqi *Rregullorja për Sekretariatën e KPK-së*, me çka është siguruar ndarja e funksioneve të Kryeprokurorit të Shtetit dhe të KPK-së. Ndonëse ka pasur progres, në veçanti sa i përket KPK-së, nevojiten edhe angazhime të mëtejme për ta ngritur qëndrueshmërinë institucionale të dy Këshillave.

KGJK dhe KPK janë përgjegjëse për të siguruar sistem gjyqësor dhe prokurorial të pavarur, profesional dhe të paanshëm. Të dy Këshillat veprojnë në mënyrë të pavarur nga ekzekutivi – masë kjo e ndërmarrë për të siguruar pavarësinë e gjyqësorit. KGJK dhe KPK janë përgjegjëse për menaxhimin e tërë sistemit gjyqësor.

Përgjatë tërë periudhës raportuese, KGJK administroi procesin e punësimit të gjyqtarëve për Gjykatat Themelore (53 nga 61 vende janë plotësuar) dhe përmbylli emërimin e pesë kryetarëve të gjykatave, kurse KPK përfundoi punësimin e 25 prokurorëve për Prokuroritë Themelore, emërimin e shtatë kryeprokurorëve të prokurorive themelore, kryeprokurorin e PSRK-së dhe të Prokurorisë së Apelit, si dhe në qershor 2017 nisi procedurat e reja për përzgjedhjen e 18 prokurorëve shtesë në nivelin e prokurorive themelore. Më tej, në mars 2017, KPK avancoi tre prokurorë në PSRK. Gjatë punësimit të gjyqtarëve të rinj për gjykatat themelore, KGJK është ballafaquar me sfidën e numrit të pamjaftueshëm të kandidatëve dhe zbatoi një masë për uljen retroaktive të pragut për testin kualifikues për gjyqtarë. Kjo masë më vonë u anulua pas këshillave të institucioneve nga familja e BE-së, me qëllim që të mos rrezikohej integriteti dhe transparenca e procesit të përzgjedhjes. KPK, në anën tjetër, i menaxhoi me sukses proceset e punësimit deri në fund.

Edhe procedurat e përzgjedhjes së kryetarëve të Gjykatës Supreme dhe të Gjykatës së Apelit janë zhvilluar gjatë periudhës së raportimit, rezultatet e të cilave janë ankimuar tek Gjykata Kushtetuese. Ky ishte zhvillim i rëndësishëm në procesin e përzgjedhjes së pozitave drejtuese në gjyqësor. Në qershor 2017, Gjykata Kushtetuese vendosi që procedura e ndjekur për përzgjedhjen e kryetarit të Gjykatës Supreme ishte jokushtetuese, ku KGJK-së iu kërkua ta ndryshonte procedurën për të garantuar që procesi i përzgjedhjes të bëhet sipas parimeve të barazisë, meritave, transparencës dhe të qenit të hapur. Duke i respektuar gjykimet, KGJK do të përmirësonte perceptimin e opinionit në lidhje me procesin e përzgjedhjes. Meqë e njëjta procedurë përdoret nga të dy Këshillat për përzgjedhjen në shumë pozita drejtuese, ky vendim mund të ndikojë në të gjitha procedurat e përzgjedhjes në të ardhmen, duke e përmirësuar më tej pavarësinë e sistemit gjyqësor.

Një hap i rëndësishëm në drejtim të rritjes së llogaridhënies së gjyqtarëve dhe prokurorëve ka qenë përgatitja e projekt *Ligjit për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve*.

Të dy Këshillat kanë punuar për miratimin e legjislacionit sekondar, d.m.th. rregulloreve, pas kërkesave të BE-së të përcaktuara në “Pakon e Drejtësisë 2015”. KPK ka arritur t’i hartojë të gjitha rregulloret që kërkoheshin nga kjo Pako. Për KGJK-në kanë mbetur edhe disa rregullore që duhen miratuar, shumica prej tyre ishin duke u përgatitur në kohën e përpilimit të këtij Raporti. Të dy Këshillat vazhdojnë t’i identifikojnë në mënyrë proaktive fushat që kanë nevojë për legjislacion sekondar dhe vazhdojnë të miratojnë rregulloret e tjera përkatëse përtej “Pakos së Drejtësisë 2015”.

Komisionet Normative të dy Këshillave dhe sekretariatet e tyre (që janë përgjegjëse për hartimin e rregulloreve) duhet t’i rrisin kapacitetet e personelit të tyre për të hartuar në mënyrë të pavarur legjislacionin sekondar me cilësi të mjaftueshme dhe sipas standardeve ndërkombëtare. Për më shumë, zbatimi efektiv i rregulloreve tashmë të miratuara nga KGJK dhe KPK kërkon vëmendje të posaçme.

Ndryshimet në “Pakon e Drejtësisë 2015” kanë kërkuar reforma strukturore të thella të cilat e kanë sfiduar procesin e arritjes së qëndrueshmërisë së plotë institucionale të dy Këshillave. Për shembull, ndryshimi pothuajse i plotë i anëtarëve të KGJK-së dhe KPK-së në vitin 2016, si dhe i kryesuesve dhe drejtorëve të sekretariateve të këtyre dy institucioneve (pas kornizës rregullative të re dhe skadimit të mandateve të anëtarëve të KGJK-së), ka sjellë disa sfida, ndërsa si efekt anësor erdhi deri te humbja e memories institucionale, në formë të proceseve institucionale, procedurave, standardeve dhe praktikave të përvetësuara gjatë mandatit të mëparshëm. Të dy Këshillat kanë ndërmarrë masa për t’i tejkaluar këto sfida. KPK, duke funksionuar vetëm me 10 anëtarë, vazhdon të ballafaqohet me rrezikun e mosarritjes së kuoromit prej nëntë anëtarësh, nga fakti se është ende në pritje të emërimit të tre anëtarëve jo-prokurorë nga Kuvendi i Kosovës. KGJK dhe KPK kanë probleme me pamjaftueshmëri të fondeve. Rrjedhimisht, me qëllim që buxheti të shfrytëzohet në mënyrë racionale, KPK e ka ndryshuar urdhëresën administrative për shpenzimet e përfaqësimit.

Zhvillim pozitiv është se KPK e ka përmirësuar procesin e planifikimit duke zbatuar praktikën e planeve të punës në secilin nivel. Kjo iniciativë e drejtuar plotësisht nga vendasi i ka dhënë KPK-së një shtytje të rëndësishme, e cila deri në qershor 2017 i ka kryer tashmë 30% të aktiviteteve të planifikuara. Për më tepër, KPK ka krijuar komisionet dhe njësitë *ad-hoc* për trajtimin e veprave penale me prioritet (d.m.th. korrupsioni, krimet ekonomike) dhe ka instaluar pajisjet për përkthim dhe video-konferenca në pothuajse secilën prokurori.³

³ Me përjashtim të Prokurorisë Themelore në Gjakovë dhe Prokurorisë Themelore në Mitrovicë

RREGULLORET E MIRATUARA⁴

KGJK

- për transferimin dhe caktimin e gjyqtarëve
- për ndryshimet në rregulloret për vlerësimin e performancës së gjyqtarëve
- për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores për procedurat e përzgjedhjes, emërimit, vlerësimit, suspendimit dhe largimit nga detyra të gjyqtarëve kryesues dhe gjyqtarëve mbikëqyrës
- për përzgjedhjen, emërimin dhe largimin nga detyra të drejtorit të Sekretariatit të KGJK-së
- për unifikimin e tarifave gjyqësore
- për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores për procedurat për rolin dhe mandatin e bordit menaxhues të projektit CMIS

KPK

- për procedurën disiplinore për anëtarët e KPK
- për emërimin e kryeprokurorëve
- për aktivitetet, organizimin e brendshëm, dhe sistematizimin e vendeve të punës në sekretariatit e KPK
- për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores për përzgjedhjen e kryesuesit dhe zëvendës-kryesuesit të këshillit
- për ndryshimin e rregullores për bordin drejtues të projektit ICT-CMIS
- për komisionin për administrimin e prokurorive
- për klasifikimin e informatave
- për komisionin për buxhet, financa dhe personel

RREGULLORET NË PROCES TË PËRGATITJES

KGJK

- për gjyqtarët porotë
- për ndryshimet në rregulloren për organizimin e brendshëm të gjykatave
- për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores për procedurat e përzgjedhjes, emërimit, vlerësimit, suspendimit, dhe largimit nga detyra të kryetarit të gjyqtarëve dhe gjyqtarëve mbikëqyrës
- për angazhimin e zyrtarëve, mbështetjes teknike dhe procedurave të tjera të nevojshme për përmbushjen e mandatit të komisionerit
- për asamblenë e përgjithshme të Gjykatës Supreme
- për asamblenë e kryetarëve të gjykatave
- për politikat dhe standardet për trajnimin e gjyqtarëve, gjyqtarëve porotë dhe stafit tjetër gjyqësor;

KPK

- për arkivin
- për qasjen në dokumente publike
- për bartjen, ruajtjen dhe shpërndarjen e informatave të klasifikuara
- për mbrojtjen e të dhënave personale

⁴ Mbulon periudhën e raportimit nga korrik 2016 deri qershor 2017 dhe nuk kufizohet vetëm në rregulloret që dalin nga Pako e Drejtësisë 2015.

DHOMA E POSAÇME E GJYKATËS SUPREME

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme (DHPGJS) ka vazhduar me gjykimin e lëndëve me kolegje të përziera me përfaqësime shumicë nga vendorët. Nga korriku 2016 deri në qershor 2017, DHPGJS ka zgjidhur 2,182 lëndë, rezultat ky i ngjashëm me normën e gjykimeve gjatë viteve të mëparshme. DHPGJS

DHPGJS merret me çështjet që lidhen me privatizimin, përfshirë kërkesat që kanë të bëjnë me privatizimin e ndërmarreve shoqërore, të kryer nga Agjencia Kosovare e Privatizimit. Disa prej kërkesave përfshijnë asete në vlerë shumë milionëshe.

në ndërkohë arriti të gjejë bilanc mes kërkesave të paraqitura dhe aktgjykimeve të dhëna apo vendimeve procedurale. Kjo ka qenë sfidë që nga viti 2013, kur vëllimi i punës shënoi ngritje të madhe për shkak të numrit të lartë të kërkesave të paraqitura në lidhje me likuidimin. Megjithatë, meqë Dhoma ende është duke pranuar kërkesa të reja çdo ditë, numri i lëndëve të pashqyrtuara vazhdon të jetë i lartë (21,001 padi në qershor 2017).

DHPGJS ka arritur progres të konsiderueshëm sa i përket trajtimit të përkthimeve të pakryera, të cilat janë reduktuar për 70% gjatë periudhës së lartcekur falë ndryshimeve strukturore në njësinë e përkthimit në EULEX, si

dhe kontraktimit të shërbimeve të përkthimit të dokumenteve në pritje. Nga fundi i vitit 2017, numri i faqeve që presin të përkthehen është 5,068 (mes gjuhëve shqip, serbisht, dhe anglisht).

DHPGJS ka përcjellë rekomandimet e Institucionit të Avokatit të Popullit duke iu përgjigjur kërkesave për përmirësimin e performancës së gjykatës. Në përgjithësi, një pyetësor është shpërndarë mes punonjësve të DHPGJS për identifikimin e pengesave brenda gjykatës dhe për zhvillimin e një strategjie për rritjen e efikasitetit për menaxhimin e përditshëm dhe procesimin e lëndëve. Në këtë drejtim është themeluar një grup pune i cili shumë shpejt pritet të bëhet operacional. Gjyqtarët e EULEX-it kanë vazhduar t'u ofrojnë mbështetje kolegjiale homologëve të tyre vendorë, të cilët qysh prej ristrukturimit të angazhimit të EULEX-it në vitin 2014 gradualisht kanë marrë përsipër kompetencat.

Largimi potencial i EULEX-it nga DHPGJS kërkon diskutime të gjera dhe strategji gjithëpërfshirëse për tranzicion, ku do të adresoheshin ndryshimet e nevojshme të Ligjit për DHPGJS si dhe mungesa e kandidatëve vendas të kualifikuar. Gjyqtarët e EULEX-it janë të gatshëm të angazhohen nëpër grupe pune relevante të udhëhequra nga Ministria e Drejtësisë, dhe të ofrojnë ekspertizën e tyre.

Ekziston nevojë imediate për përmirësimin e punës së regjistrit, i cili ka nevojë urgjente që të zbatohet një sistem të duhur dhe të qëndrueshëm për menaxhimin e lëndëve. Gjetja e dosjeve në objektet e regjistrit është shumë e vështirë, dhe dosjet që janë në dispozicion – mes çështjeve të tjera – vazhdojnë të administrohen në mënyrë jokonsistente dhe iu mungon faqosja e duhur. Më tej, Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) shpeshherë ndërhyr në procedurat gjyqësore, çka ngre shqetësime duke pasur parasysh se AKP zakonisht është palë në padi. Andaj, fuqizimi i ndarjes së kompetencave është nevojë e vazhdueshme. Në fund, çështja e arsimimit të pamjaftueshëm juridik dhe profesional në Kosovë vazhdon të jetë sfidë për DHPGJS-në, meqë shumë prej profesionistëve juridikë kanë mungesë të kapaciteteve juridike dhe aftësive të domosdoshme, në një anë, për t'i përfaqësuar palët me zotësi, dhe, në anën tjetër, për të trajtuar procesin dhe për t'i gjykuar rastet në mënyrë të ligjshme.

PANELI I APELIT I AGJENCISË KOSOVARE TË PRONËS

Paneli i Apelit i Agjencisë Kosovare të Pronës (AKP) ka vazhduar me gjykimin e ankesave, duke përmbyllur gjithsej 160 raste gjatë periudhës së mbuluar në këtë Raport. Sipas mandatit të ri të EULEX-it, Paneli i Apelit i AKP-së filloi me gjykimin e rasteve në panele të përziera me shumicë vendore (një gjyqtar nga EULEX dhe dy gjyqtarë vendorë) me kryesues të panelit nga vendi. Numri i përgjithshëm i gjyqtarëve të EULEX-it është zvogëluar në dy. Meqë numri i gjyqtarëve vendorë nuk është rritur sipas nevojës, kjo pati ndikim në efikasitetin e Panelit të Apelit të AKP-së, i cili nuk mundi të punonte në dy panele njëkohësisht. Paneli po mundohet të ruajë shpejtësinë e tij të gjykimeve dhe është duke punuar fuqimisht për uljen e numrit të rasteve të pashqyrtuara, ku numri i këtyre rasteve në qershor 2017 ishte 281.

Kryetari i panelit nga gjyqësori i Kosovës është paraparë të pensionohet në fillim të korrikut 2017. Ndërsa kjo pozitë e zbrazët nuk është plotësuar ende, ushtruesi i detyrës së kryetarit të Gjykatës Supreme caktoi tre gjyqtarë për ta zëvendësuar përkohësisht gjyqtarin e pensionuar me rotacion mujor deri në plotësimin e vendit të lirë.

Një prej sfidave të vazhdueshme të Panelit të Apelit të AKP është fakti se rreth 1,236 vendime fillestare të AKP (kundër të cilave palët mund të paraqesin ankesë tek Paneli i Apelit i AKP) nuk mund dorëzohen ngase shumë serbë të Kosovës janë larguar nga Kosova. Ndonëse paneli merret me një lloj shumë të veçantë të kontesteve pronësore që ndërlidhen vetëm me konfliktin (në mënyrë më specifike për

Paneli i Apelit i AKP-së është pjesë e Gjykatës Supreme dhe merret me ankesa kundër vendimeve të dhëna nga AKP për konteste pronësore private. Paneli i Apelit merret vetëm me pronat private dhe të paluajtshme që janë humbur gjatë dhe për shkak të konfliktit 1999. Shumica e ankesave janë raste kontestuese mes grupeve etnike të ndryshme (shqiptarë të Kosovës/serbë të Kosovës).

periudhën nga shkurt 1998 deri qershor 1999), mund të jetë e nevojshme që ai të duhet të vazhdojë të funksionojë deri në dorëzimin e të gjitha vendimeve fillestare të AKP. Andaj, në mënyrë që të përmbyllet të gjitha kontestet pronësore që ndërlidhen me konfliktin e vitit 1999, është e nevojshme të themelohet një mekanizëm për gjurmimin e palëve të kërkesave dhe për dorëzimin e vendimeve.



SHËRBIMI KORREKTUES I KOSOVËS

Shërbimi Korrektues i Kosovës (SHKK) ka shënuar progres të pakët në zhvillimin e tij drejt standardeve të BE-së meqë vazhdon të pengohet nga ndërhyrje të vazhdueshme. Trajtimi preferencial i të burgosurve të profilit të lartë, vlerësimi dhe kategorizimi joadekuat i të burgosurve, si dhe radikalizimi i të burgosurve vazhdojnë të jenë sfida domethënëse. Ndërkaq, progres i caktuar është shënuar sa i përket përcjelljes së të burgosurve dhe vendosjes së duhur të burgosurve nëpër objektet korrektuese.

Trajtimi preferencial i të burgosurve të profilit të lartë vazhdon të jetë sfidë e madhe në fushën e korrektimit. Të burgosurit e profilit të lartë gëzojnë kushte të zbutura të burgimit, vizita të shpeshta në shtëpi dhe pushime të jashtëzakonshme, si dhe pako ushqimore shtesë në krahasim me të burgosurit e tjerë, dhe kategorizohen në një mënyrë të pastandardizuar të favorshme për ta. Proceset e vrojuara në mundësimin e përsëritur të hospitalizimeve afatgjata, si dhe në një rast suspendimin e dënimit për shkak të arsyeve mjekësore – posaçërisht të burgosurve të profilit të lartë – kanë bërë që të ngritën shqetësime serioze. Një përmirësim në këtë aspekt është vërejtur me fillimin e detyrës së ministres së re të drejtësisë në gusht të vitit 2016, ku ajo i revokoi të gjitha tetë suspendimet e dënimeve të bëra për shkaqe shëndetësore që ishin në pritje nga administrata e mëparshme. Më tej, ndryshimet në *Ligjin për ekzekutimin e sanksioneve penale* hynë në fuqi në fund të muajit maj 2017, ku u bë bartja e vendimmarrjes për suspendimin e dënimeve për shkaqe shëndetësore nga Ministria e Drejtësisë tek gjyqësori. Edhe pse ligji i ndryshuar e kufizon mundësinë për ndërhyrje politike, EULEX do të vazhdojë monitorimin që zbatimi i vendimeve të jetë i drejtë dhe të jep barazi për të gjithë të burgosurit.


Procesi i kategorizimit të burgosurve vazhdon të jetë i mangët meqë zbatohet kryesisht në bazë të sjelljes së dukshme dhe mungesës së akuzave të tjera në proces. Rregullorja për kategorizimin e të burgosurve vazhdon të shkelet për shkak të vëmendjes së pamjaftueshme kushtuar historikut penal të burgosurve. Si rezultat, kjo ua mundëson vazhdimin e veprimtarive penale gjatë qëndrimit në burg, dhe ua mundëson ndikimin e tyre politik tek të burgosurit e tjerë, punonjësit e korrektimit dhe palët e jashtme. SHKK gjithashtu nuk ka arritur të bëjë kategorizimin e duhur të asnjë të burgosuri të profilit të lartë pa presionin e jashtëm nga komuniteti ndërkombëtar. Në rastet kur është bërë kategorizim i duhur, të burgosurit e profilit të lartë në ndërkohë janë degraduar prapë gjatë rishikimeve periodike të kategorizimeve të tyre për shkak të presioneve të vazhdueshme politike mbi SHKK. Degradimi i dy të burgosurve të profilit të lartë në janar dhe prill 2017, kundër këshillave të EULEX, janë shembuj të freskët të kësaj praktike.

Radikalizimi i të burgosurve është fenomen shqetësues në mesin e të burgosurve në objektet e SHKK, meqë terroristë të dënuar dhe të burgosur të radikalizuar kanë ndikim mbi të burgosurit e tjerë. Rreziku më i lartë nga përhapja e radikalizimit është në Qendrën Korrektuese në Dubravë, meqë të burgosurit atje kanë shumë mundësi të socializohen dhe të punojnë së bashku. Duke pas parasysh se ajo është qendër korrektuese, niveli i kontrollit mbi të burgosurit është më i ulët sesa në qendrat e paraburgimit apo në Burgun e Sigurisë së Lartë në Podujevë. SHKK ka reaguar ndaj problemit përmes zhvendosjes të disa të burgosurve të radikalizuar nëpër pavijone të ndryshme për të reduktuar kontaktet dhe ndikimin

tek të burgosurit e tjerë, dhe përmes kryerjes së kërkimeve për konfiskimin e materialeve të ndjeshme. Ndërsa SHKK ka treguar qasje serioze për luftimin e problemit, mbështetje e mëtejme nevojitet për vazhdimin e masave të deradikalizimit brenda objekteve të SHKK.

SHKK ka ndërmarrë hapa të caktuar pozitivë në fushën e përcjelljes së të burgosurve, ngase stafi ka vepruar në përputhje me rregullat dhe rregulloret në mënyrë më konsistente. Megjithatë, ende ka shumë zbrazëtira dhe parregullsi sa i përket sigurisë. Ka shqetësime të vazhdueshme në lidhje me përdorimin jo të duhur të dritave të kaltra, vozitjen e rrezikshme, mospërdorimin e rripave të sigurisë, dhe kushtet teknike jo të mira të veturave që përdoren për përcjellje. Në ndërkohë, zyrtarët e përcjelljeve kanë nevojë për trajnime përsëritëse për përdorimin e forcës dhe të armëve të zjarrit, si dhe për dhënien e ndihmës së parë. Më shumë punë duhet të bëhet në lidhje me trajtimin e duhur të të dhënave mjekësore dhe të mostrave për analiza, caktimin paraprak të vizitave tek mjeku, specifikimin e përgjegjësive të stafit mjekësor dhe korrektues gjatë përcjelljeve në spitale, përmirësimin e përgatitjeve dhe planifikimeve të këtyre përcjelljeve, dhe caktimin e më shumë burimeve për kryerjen e tyre. Kjo po ashtu ka të bëjë me sigurinë që iu ofrohet të burgosurve të hospitalizuar. Duke e pas parasysh se dhomat e sigurta të rinovuara kohëve të fundit në ish-pavijonin e psikiatrisë në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës nuk janë vënë në përdorim për shkak të ngurrimit të personelit mjekësor, SHKK është e obliguar të sigurojë pavijonet e rregullta spitalore me prani të madhe të SHKK për parandalimin e ikjes së të burgosurve.

Me vendosjen e pesë të burgosurve (dy serbë të Kosovës, një malazez, një boshnjak, dhe një serb) në Burgun e Sigurisë së Lartë në Podujevë që nga nëntori 2016, SHKK ka ndërmarrë një hap përpara drejt vendosjes së duhur të burgosurve nëpër objekte në përputhje me vlerësimin e rrezikut dhe nevojave. Megjithatë, ri-integrimi i stafit dhe të burgosurve shqiptarë të Kosovës në Qendrën e Paraburgimit në Mitrovicë mbetet çështje në pritje.



INSTITUTI I MJEKËSISË LIGJORE

Instituti i Mjekësisë Ligjore (IML) është përgjegjës për kryerjen e ekspertizave të mjekësisë ligjore dhe ekspertizave mjekësore të vdekjeve për nevoja hetimore. Këtu përfshihen kërkimet e personave të pagjetur nga konflikti i vitit 1999⁵, zhvarrimi i mbetjeve mortore të njerëzve dhe kthimi i mbetjeve tek familjarët.

Deri në fund të periudhës së mbuluar në këtë raport, 1,659 persona figurojnë të pagjetur si pasojë e konfliktit. IML punon intensivisht për gjetjen dhe identifikimin e zonave ku mund të ketë mbetje mortore. Mes korrikut 2016 dhe qershorit 2017, në Kosovë janë gërmuar 17 lokacione. Nëntë operacione në teren kanë rezultuar me 16 raste të zhvarrimit të mbetjeve mortore nga lokacione të ndryshme. Vlerësimi i fundit në teren i kryer në Kizhevak të Serbisë përfundoi në qershor 2017. Si rezultat i këtyre proceseve, gjatë periudhës raportuese janë identifikuar tetë persona.

IML ka vazhduar të përballet me sfida për arritjen e funksionalizimit të plotë si në nivel strategjik ashtu edhe në atë operacional. Progres i caktuar është arritur në nivelin strategjik: pas miratimit të *Ligjit për mjekësinë ligjore* në mars 2016, Departamenti i Mjekësisë Ligjore (atëherë nën Ministrinë e Drejtësisë) u transformua në Institutin e Mjekësisë Ligjore. Ky qe një hap përpara për krijimin e një agjencie të pavarur të lirë nga ndërhyrjet e panevojshme. Ai u pasua me hartimin e legjislacionit sekondar i cili ende ka nevojë për finalizim dhe miratim. Mbetet edhe shumë punë për t'u bërë për fuqizimin e IML si institucion, përfshirë përzgjedhjen e drejtorit të ri në mënyrë transparente dhe sipas meritës, sigurimin e rritjes së financimit tejet të nevojshëm, si dhe finalizimin dhe ekzekutimin e një strukture të re organizative në pajtim me ndryshimet legjislative të reja.

Në nivelin operacional, kapaciteti i stafit mbetet i ulët. Përpjekjet për fuqizimin e kapaciteteve të brendshme të institutit janë bërë përmes trajnimeve të brendshme dhe të jashtme. Për shembull, dy antropologë forenzikë të ardhshëm vijuan trajnime në vend të punës të ofruara nga ana e EULEX për raste të ndërlidhura me punën në teren, ndërsa dy pjesëtarë të stafit ndoqën një trajnim teorik online rreth antropologjisë forenzike bazike, i ofruar nga Universiteti i Leicesterit. Instituti përballet me sfida në

Gërmime janë bërë në Prizren, Prishtinë, Mitrovicë Veriore, Leposaviq, Gllogovc, Zubin Potok, Kaçanik, Deçan, Malishevë, Klinë dhe Skenderaj.

Statistikat rreth personave të pagjetur

- Numri i përgjithshëm i rasteve aktive: 1,659
- Numri i rasteve të raportuar si të pagjetur: 1,395
- Numri i rasteve të raportuar si të vdekur por trupat mungojnë: 264

Sipas gjinisë: Femra 266; Meshkuj 1,393

Numri i përgjithshëm i personave për të cilët është hapur kërkesë e gjurmimit në Komitetin Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq nga familjarët: 6,055

**Informatat e paraqitura në këtë kuti janë dhënë nga Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq në korrik 2017.*

⁵ Mandati i IML e mbulon periudhën 1 janar 1998 – 31 dhjetor 2000.

reduktimin e numrit të raporteve të papërfunduara të autopsive dhe raporteve të ekzaminimeve klinike, duke e vënë kështu progresin e hetimeve penale në rrezik ngase mungojnë provat e nevojshme. Ka pasur përpjekje të bashkërenduar mes EULEX dhe Institutit për reduktimin e numrit të papërfunduar të raporteve të autopsive përmes identifikimit të qartë dhe prioritizimit të rasteve. Më tej, duke e pasur parasysh se laboratorit i toksikologjisë ka filluar të jep rezultate, numri i punëve të papërfunduara pritet të ulet konsiderueshëm deri në vitin 2018. Megjithatë, meqë Instituti ende nuk ka sistem funksional për menaxhimin e rasteve, përcjellja e progresit të rasteve dhe krijimi i statistikave të besueshme janë shumë të vështira.

Sa i përket sfidave me të cilat përballet IML, dhe duke pas parasysh rëndësinë e madhe të mjekësisë ligjore për kërkimin e personave të pagjetur, shumë punë duhet të bëhet për ngritjen e IML në institut të fuqishëm dhe efikas.



ZBATIMI I DIALOGUT



REGJISTRI CIVIL




Foto: Zyra e Regjistrimit Civil në Komunën e Zveçanit

të Gjendjes Civile plotësisht funksionale në të gjitha katër komunat. Në këto zyra bëhet regjistrimi i të dhënave personale të banorëve të përkohshëm dhe të përhershëm të Kosovës, si lindjet, statusi familjar, vdekjet, andaj kjo do të ishte esenciale për regjistrimin e popullatës në kornizën e Kosovës. Shërbime të kufizuara të këtij lloji aktualisht ofrohen në Mitrovicën Veriore, ndërsa banorët në tri komunat e tjera veriore iu qasen shërbimeve të regjistrimit civil vetëm përmes zyrave të vendit në fshatrat e largëta me shumicë shqiptare të Kosovës nëpër komunat e tyre. Vonesat në miratimin e një udhëzimi administrativ të paraparë për ndryshimin e kushteve të tanishme për marrjen e shtetësisë së Kosovës, si dhe vonesa në integrimin e 39 punonjësve administrativ nga ish-MUP (Ministria e Serbisë për Punë të Brendshme) që pritet të vendosen nëpër Zyrat e Gjendjes Civile janë pengesa të konsiderueshme ndaj themelimit të shërbimeve plotësisht funksionale të statusit civil dhe të regjistrimit civil në veri të Kosovës.

Progres i konsiderueshëm është shënuar me hapjen e Zyrave të Regjistrimit Civil në katër komunat veriore në dhjetor 2016. Të gjitha katër zyrat janë bërë operacionale, përmes lëshimit të letërnjoftimeve, pasaportave, patentave të shoferit dhe regjistrimeve të veturave për banorët. Lëshimi i letërnjoftimeve për serbët e Kosovës në veçanti ka shënuar trend në rritje (shih diagramin më poshtë).

Ndërsa, nevojitet përkushtim i mëtejshëm për themelimin e Zyrave

Marrëveshja për librat e regjistrimit civil mes Prishtinës dhe Beogradit është arritur në Bruksel në vitin 2011. EULEX i ofroi asistencë Agjencisë së Kosovës për Regjistrimin Civil për themelimin e një sistemi plotësisht të besueshëm të gjendjes civile. Gjendja Civile i përmban të gjitha informatat relevante për fazat e ndryshme të jetës së individit, si lindja, martesja, apo vdekja. Gjendja civile e besueshme është tejet e rëndësishme meqë iu ofron banorëve siguri ligjore, shërben si themel për sistem elektoral të besueshëm (përfshirë listat e votuesve) dhe është e nevojshme për trajtimin e çështjeve që ndërlidhen me sigurinë, arsimin, shëndetësinë dhe ekonominë.



Grafiku: Numri i përgjithshëm i kërkesave për letërnjoftime nga serbët e Kosovës në veri të Kosovës

BE ka mbështetur Agjencinë e Regjistrimit Civil në përpjekjet e saj për rritjen e konsistencës, qëndrueshmërisë dhe funksionalitetin e shërbimeve të gjendjes civile në Kosovë. Në dhjetor të vitit 2016, një projekt i financuar nga BE për digjitalizimin e kopjeve të certifikuara të librave të regjistrave civil është përmbyllur, ku u bë kompletimi i regjistrimit të dhënave për të gjitha 2,883,248 shënimeve ekzistuese. Një projekt përcjellës për verifikimin e të dhënave filloi në shkurt 2017 dhe deri në qershor, 55% e të dhënave ekzistuese janë verifikuar. Ndërsa projektet e mëparshme dhe ato aktuale quan procesin në drejtimin e duhur, EULEX ka vazhduar të theksojë nevojën për integrimin e plotë të dhënave në sistemin qendror të gjendjes civile – digjitalizim i vërtetë i të gjitha të dhënave siç është paraparë me dialogun e lehtësuar nga BE në vitin 2011.

Më tej, performanca efektive e gjendjes civile dhe e regjistrimit civil varet nga aranzhimet dhe bashkëpunimi mes institucioneve të ndryshme të administratës publike dhe të sundimit të ligjit. Ndonëse janë nënshkruar marrëveshje për lehtësimin e zbatimit në fushat e përbashkëta, bashkëpunimi kuptimplotë ose është i ngadaltë ose ka munguar tërësisht. Vullnet politik i mëtejshëm nevojitet në anën e autoriteteve të Kosovës për avancimin e përputhshmërisë teknike me sistemet dhe regjistrat, dhe përmirësimin e legjislacionit që i mbulon fushat e kompetencave të përbashkëta. Autoritetet e Kosovës po ashtu ende kanë nevojë për adresimin e zbrastërave të shumta të pranishme mes praktikave aktuale dhe kornizës juridike për rregullimin e fushës së regjistrimit civil, me qëllim të harmonizimit të legjislacionit dhe afrimit me praktikat më të mira të BE-së.

LIRIA E LËVIZJES

Marrëveshja për lirinë e lëvizjes e arritur në vitin 2011 është zbatuar në tërësi në pjesën jugore të Kosovës. Gjatë një takimi përcjellës rreth marrëveshjes për lirinë e lëvizjes të mbajtur në Bruksel në shtator 2016, dy palët janë pajtuar që targat provuese më nuk do të lëshohen nëpër pikët e përbashkëta të kalimit (PPK). Në vend të kësaj, janë paraparë letra ngjitëse për mbulimin e shkurtesave dhe të stemave në targat e veturave të Kosovës dhe Serbisë gjatë lëvizjes nëpër territoret e tjetrës. Seria e parë prej 300,000 fletëve ngjitëse është prokuruar përmes një procedure të shpejtë nga Ministria e Kosovës për Punë të Brendshme, dhe ato priten të jepen gjatë korrikut 2017.

Ndërsa, zbatimi i dispozitave të tjera të parapara në marrëveshjen përcjellëse të lidhur në shtator 2016, në masë të madhe vazhdon të jetë në pritje. Në shkurt 2017, Zyra e Kryeministrit lëshoi një vendim për miratimin e të gjitha aranzhimeve në lidhje me finalizimin e marrëveshjes përcjellëse për lirinë e lëvizjes. Ndonëse Ministria e Punëve të Brendshme dhe Ministri pa Portofol, të përqendruar në procesin e dialogut të lehtësuar nga BE, që atëherë kanë mbajtur një sërë takimesh për përcaktimin e modaliteteve të këtij vendimi, nevojitet përkushtim i fuqishëm për shtyrjen përpara të procesit të zbatimit. Si rezultat i rekomandimeve nga EULEX, në qershor 2017, Ministria e Punëve të Brendshme e finalizoi hartimin e dy udhëzimeve administrative, njëra për mundësimin e vazhdimin të regjistrimit të veturave me targa KS, dhe tjetra për ndryshimin e kushteve aktuale për marrjen e shtetësisë së Kosovës (që si rezultat do të lehtësojë lëshimin e dokumenteve të Kosovës). Për shkak të pasigurisë politike në vazhdim dhe shpërbërjes së qeverisë, nuk është shënuar progres në miratimin e tyre, edhe pse Zyra e Kryeministrit ka dhënë opinion juridik ku theksohej se nuk kishte pengesa juridike që Ministri i Punëve të Brendshme t'i nënshkruante projekt-udhëzimet administrative. Më tej, me përjashtim të disa degëve të bankave të Kosovës në Mitrovicën Veriore, objektet dhe infrastruktura e nevojshme për regjistrimin e veturave në përputhje me kornizën e Kosovës nëpër komunitatet e veriut, siç janë degët e bankave të Kosovës, shërbimet e kontrollit teknik, degët e sigurimit, dhe autoshkollat, ende mungojnë dhe ato duhet të themelohen me qëllim të zgjerimit të plotë të zbatimit të marrëveshjes për lirinë e lëvizjes edhe në veri.

Ministria e Punëve të Brendshme ka shënuar progres të rëndësishëm për lehtësimin e ri-regjistrimit të edhe 1,239 veturave me targa të përkohshme të regjistrimit, që fillimisht qenë regjistruar me targa KS pas vitit 1999. Vlefshmëria e targave KS skadoi në nëntor 2016, por është zgjatuar për pesë vite të tjera, sipas marrëveshjes në Bruksel në shtator 2016. Si rezultat i rekomandimeve nga EULEX dhe në bazë të vendimit të fundit të Ministrit të Punëve të Brendshme, pronarët e veturave lirohen nga pagesa e tarifave doganore për ri-regjistrimin e këtyre veturave. Andaj, procesi i zëvendësimit filloi në maj 2017, me 449 targa të zëvendësuara deri në qershor.

Marrëveshja e vitit 2011 për lirinë e lëvizjes ka dalë nga dialogu mes Prishtinës dhe Beogradit, i lehtësuar nga BE. Marrëveshja parasheh lëvizjen e lirë të personave dhe veturave dhe është e bazuar në parimin e reciprocitetit të plotë mes Kosovës dhe Serbisë. Në praktikë, ajo ia mundëson popullatës që jeton në Kosovë të lëvizin në Serbi me dokumente udhëtimi të Kosovës, dhe anasjelltas. Një element i rëndësishëm i marrëveshjes është ajo që Prishtina ashtu edhe Beogradi kanë vendosur të lejojnë udhëtimin nëpër pikët e kalimit me letërnjoftime.

MARRËVESHJA PËR MIK/IBM

Pas vonesave që zgjatën për muaj të tërë, ceremonia për fillimin e ndërtimit të një prej gjashtë Pikëve të përhershme të Përbashkëta të Kalimit (PPK) mes Kosovës dhe Serbisë u mbajt në shkurt 2017 në Merdarë. Me këtë u shënua një ngjarje e rëndësishme sa i përket dialogut mes Beogradit dhe Prishtinës, meqë shënoi progres të vërtetë në procesin e themelimit të gjashtë PPK të përhershme. Ndërtimi i PPK në Merdarë filloi solemnisht në fund të muajit shkurt, ndërsa lejet për ndërtimin e dy PPK në territorin e Kosovës janë ende në pritje. Në ndërkohë, Beogradi ka raportuar se për përfundimin e tri PPK të tyre do të nevojiten 30 muaj kohë nga nënshkrimi i memorandumit të mirëkuptimit me Zyrën e Kombeve të Bashkuara për Shërbimet e Projekteve në Serbi.



Foto: Ceremonia e vendosjes së gurthemelit për ndërtimin e PPK-së në Merdarë, ©Zyra e BE në Kosovë/PSBE

Takimet e para bilaterale të ndara mes Beogradit dhe Prishtinës janë mbajtur me policinë kufitare, doganën, dhe inspektoratet fitosanitare dhe veterinare. Këto takime, të promovuara dhe të lehtësuara nga EULEX janë mbajtur në Kosovë dhe në Serbi me një frymë pozitive të bashkëpunimit. Takimet po

IBM-MIK në kontekstin e dialogut Prishtinë-Beograd i referohet protokollit teknik për zbatimin e konkluzioneve të miratuara për MIK nga viti 2011 dhe planin e veprimit nga viti 2012 – i dedikohet themelimit të gjashtë pikëve të përbashkëta të kalimit mes Kosovës dhe Serbisë.

ashtu ishin shumë produktive, me konkluzione për aktivitete të përbashkëta të mëtejme dhe bashkëpunim të shtuar nga autoritetet e të dy palëve.

Me lehtësimin e bërë nga EULEX-i, grupi punues teknik për Shkëmbimin Elektronik Sistemik të Dhënave (SHESDH) u themelua në shkurt 2017, me përbërje nga përfaqësues doganorë nga Beogradi dhe Prishtina, ekipi për mirëmbajtjen e SHESDH dhe EULEX-i. Objektiva kryesore e grupit punues teknik është zgjidhja e shpejt e çdo çështjeje për kalimin e mallrave komerciale nëpër PPK. Takimi i parë i grupit punues teknik për SHESDH u mbajt në mars 2017, dhe mund të konsiderohet si

zhvillim tjetër domethënës drejt normalizimit të marrëdhënieve mes Prishtinës dhe Beogradit, meqë ka themeluar komunikimin e parë të drejtpërdrejtë mes përfaqësuesve doganorë nga të dyja palët e dialogut.

INTEGRIMI I DREJTËSISË

Në frymën e vendimeve të mëparshme, gjatë verës 2016, KGJK dhe KPK shpallën pozitat për 14 gjyqtarë, 5 prokurorë dhe 149 punonjës mbështetës për pjesën veriore të Kosovës. Vendet e lira për gjyqtarë dhe prokurorë ishin për pozitat që nuk ishin plotësuar në radhën e parë në vitin 2015. Si rezultat i procesit të përzgjedhjes, pozitat për 12 gjyqtarë, 5 prokurorë dhe 148 punonjës mbështetës u plotësuan (mbetën tri vende të lira). Gjatë një takimi në Bruksel në kuadër të dialogut, palët ranë dakord që gjyqtarët, prokurorët dhe punonjësit mbështetës serbë të Kosovës të punësuar së fundmi (pas dorëheqjes nga pozitat e tyre në Serbi) do të nënshkruajnë deklaratën e integritit dhe zyrtarisht t'i bashkohen sistemit të drejtësisë të Kosovës më 10 janar 2017. Megjithatë kjo ngjarje nuk u mbajt asnjëherë për shkaqe politike në lidhje me dialogun, dhe data e integritit u shty.

Një temë tjetër e rëndësishme për integrimin në drejtësi ka qenë gjendja e ndërtesave të gjykatave që, pas shumë vitesh neglizhence pjesërisht nuk ishin të gatshme të akomodonin personelin që pritej të fillonte punën. Ka pasur përpjekje për t'i sjellë objektet në gjendje të pranueshme, por meqë disa prej tyre nuk ishin duke u përdorur, ato vazhduan të përkeqësohen. Në vitin 2017, Zyra e BE-së nënshkroi kontrata në vlerë €45,000 për renovimin e dy objekteve të gjykatës: objektit *Jugobanka* në Mitrovicën Jugore dhe objektit aktual të gjykatës në Mitrovicën Veriore, për t'u përfunduar në fund të verës 2017. Një projekt për renovimin e qendrës së paraburgimit në Mitrovicën Veriore do të kushtojë €200,000 dhe pritet të përfundohet deri në fund të vitit 2017. Ndërtesa e Prokurorisë Themelore në Lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicën Veriore është e gatshme për të akomoduar prokurorinë.

Duke e përmbledhur, shumica e aspekteve teknike të integritit në drejtësi ishin adresuar deri në qershor 2017. Megjithatë, nuk është shënuar asnjë zhvillim për shkak të sfidave të vazhdueshme në dialogun mes Prishtinës dhe Beogradit që, nga ana e vet, është ngadalësuar nga zgjedhjet në Serbi si dhe ato në Kosovë.

Integrimi i sistemit të drejtësisë në Kosovën veriore është një prej shumë proceseve të ndërlydhura me dialogun mes Kosovës dhe Serbisë. Gjyqtarët dhe prokurorët serbë të Kosovës vazhdojnë të jenë zyrtarisht të punësuar në sistemin ligjor të Serbisë, gjë që ka ndikim të madh në jetën e përditshme të qytetarëve të rëndomtë. Në vitet 2013 dhe 2015 u morën një numër vendimesh politike për themelimin e një kornize të unifikuar gjyqësore në mbarë Kosovën.

LISTA E SHKURTESAVE

UA – Udhëzim Administrativ

PPK – Pikë e Përbashkët e Kalimit

IML – Instituti i Mjekësisë Ligjore

FPADH – Funkionimi i Policisë në Bazë të Analizës dhe të Dhënave

PK – Policia e Kosovës

SHKK – Shërbimi Korrektues i Kosovës

KFOR – Forca në Kosovë

KGJK – Këshilli Gjyqësor i Kosovës

AKP – Agjencia Kosovare e Pronës

KPK – Këshilli Prokurorial i Kosovës

MUP – Ministarstvo unutrašnjih poslova/ Ministria e Brendshme (Serbi)

AKP – Agjencia Kosovare e Privatizimit

IPK – Inspektorati Policor i Kosovës

DHPGJS – Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme

PSRK – Prokuroria Speciale e Kosovës

SHESDH – Shkëmbimi Elektronik Sistemik i të Dhënave



European Union Rule of Law Mission
Partnership for Justice



www.twitter.com/eulexkosovo



www.facebook.com/eulexkosovo



www.youtube.com/eulexkosovo